



Fati ynë nuk është shkruar për ne, por është shkruar prej nesh!

OBAMA

E enjte
11 shkurt 2016

Viti XVI
nr 158

Çmimi
30 L / 1 euro

E pavarur,
periodike

www.shqiperia-etnike.com
shqiperia_etnike@yahoo.com

English, page 13-14

Drejtor
Sokol Pepushaj



DREJTËSI, KËTË DUHET TA VENDOSIN TË AKUZUARIT
Fatos Lubonja
faqe 2



NË KELMEND, KU E VËRTETA NGJAN LEGJENDË
Sokol Pepushaj
faqe 8



VLERËSIMI REAL I NJE-RIUT....
Arjan Kallço
faqe 4

Pse Europa heshtë problemin e shqiptarëve të Greqisë (Çamërisë)?!

Nga: Ilir Berisha

Brenda gjirit të kufinjëve të saj të BE-së egzistojn shumë probleme të cilat i heshtin sikur mos të egzistojn ato. Problemi i Baskëve në Spanjë, Irlandezve në Mbretërin e Bashkuar Angleze i shqiptarëve të Greqisë, Çamërisë janë fiksime të pasojave Europiane që mund të eskalojnë situatën politike Brenda BE-së. Vetë politika e BE-së po i financon shtetet për heshtjen e këtyre problemeve egzistuese që donë zgjidhje...

faqe 3

Malesi e Madhe: Konflikti për pronat, vritet Rrok Arra

Problemet e pronësisë po marrin shumë jetë të pafajshme njerëzish. Është kjo plaga më e rëndë e shoqërisë shqiptare. Ky fenomen është më i theksuar në Veriun e Shqipërisë, çka ka regjistruar edhe numrin më të madh të viktimave. Mbrëmjen e djeshme fshati Hot u përgjak nga një konflikt për pronën, ku Lek Celaj, banues i fshatit Hot ka qëlluar për vdekje me armë zjarri shtetasin Rrok Arra, banues i fshatit Dukagjin. Ngjarja e rëndë me një të vdekur, ka ndodhur në një lokal në fshatin Hot, jo më larg se dy kilometra nga Dogana e Hanit të Hotit. Nga informacionet e shpejta, gazeta jonë mëson se në atë vend nipat e vrasësit Lek Celaj kishin ndërtuar një lokal, dhe vrasësi dhe viktimat kishin patur një konflikt pronësie. ... faqe 3

Julian Assange, Jeta deri në themelimin e "Wikileaks"

Është folur shumë për "Wikileaks" këto javë, por të pakta janë ende informacionet personale për themeluesin dhe kryeredaktorin e këtij sajti, që po ndryshon diplomacinë botërore dhe shumë koncepte që kanë të bëjnë me lirinë e shtypit. Ja cila ka qenë jeta e tij në të shkuarën. Superhakeri, i cili tanimë konsiderohet nga të gjithë si "rrjedhësi" më i madh i sekreteve ushtarake dhe diplomatike në historinë e njerëzimit, është rritur në një ishull idilik dhe të vogël të Queensland. Një ishull me vetëm 500 banorë. Ai vetë ishte një "Tom Sayer", i cili e kalonte ditën duke zënë peshk dhe zogj.

FAQE 6



Shën Shtjefni, pesë shekuj "endacak" në Shkodër

Më 1479 Shkodra kishte 405 burra dhe 105 gra

Përpara se të justifikojmë titullin e shkrimit tonë, ne po rikujtojmë se Shën Shtjefni (apo Shën Stefan) ka qenë i pari i zgjedhur nga 12 apostujt e Jezu Krishtit, në mes shtatë nxënësve të tyre, ku u zgjodh më i miri, më i urti, i mbushur me Frymën e Shenjtë, duke vendosur dorën mbi këtë, si simbol i kalimit të pushtetit shpirtëror në të shungurueshmin. ... faqe 5

Kur lufta brenda llojit quhet disidencë

Nga Ardian NDRECA

A kanë ndryshue shpirtnisht disidentat e Bllokut në vitet e burgimit apo të internimit?

Ka gjasë që burgu dhe internimi t'i ketë ndërgjegjsue rreth idesë çnjerëzore që u dha pushtet, rreth tmerrit që ata dhe familjet e tyre i shkaktuen shumicës së shqiptarëve. Mund të quhej ndryshe edhe "disidencë brenda Bllokut", por Blloku mbetë gjithsesi një metaforë e lidhjes gjeografike me një copë territori të kufizuem ku jetonin disa borgjezë shpirtvegjël të farkëtuem në momentet e çlodhjes prej "luftës së egër të kllasave". ... faqe 10

Dritëhijet e kapitalizmit "Made in China"

Rezultate ekonomike spektakolare. Tashmë Kina vlerësohet si fuqia e tretë ekonomike e botës. Mbasi "parakaloi" me shpejtësi që në vitin 2005 Francën dhe Anglinë, mbasi "shkurorëzoi" nga podiumi i ekonomisë botërore Gjermaninë në vitin 2006, në fund të verës së këtij viti, ekonomia... faqe 11

Drejtësi?! Këtë duhej ta vëndosnin të akuzuarit!



Nga Fatos Lubonja

Nuk ishte i papritur për mua numri i madh i reagimeve të atyre lexuesve që, pas shkrimit “Drejtësi – Demokraci”, m’u drejtuan duke më thënë se nuk rregullohet me paga të larta korrupsioni në Drejtësi, se 2000 euro në muaj nuk bëjnë punë, pasi këta janë mësuar me shumë më tepër, e më përmendnin pastaj, kush faktin se mjafton të shikosh se çfarë makinash kanë gjyqtarët e prokurorët tanë, kush se këta shpenzojnë deri 100 000 euro në vit vetëm për pushime, kush duke më treguar vilat e tyre e me radhë e me radhë. Nuk ishte e papritur edhe një ndjenjë nënshtrimi total ndaj këtij realiteti që shprehej në shumicën e këtyre reagimeve, ku, si ekstrem që puqet me nënshtrimin do të fusja edhe reagimet e egra të atyre që propozonin si zgjidhje efikase jo rritjen e pagave, por “dajakun”, “burgun”, “gijotinën”, duke harruar se në një demokraci “burgun” do të duhet ta vendosin po të akuzuarit në fjalë.

Nuk ishte e papritur, po ashtu, heshtja nga ana e politikës, që dihet se ka axhendën e vet, në të cilën vetëm propozim i dobësimit të pushteti të tyre në favor të pushteteve të tjera nuk mund të bëjë pjesë, siç nuk ishte e papritur edhe heshtja e shumicës së gazetarëve të llogoreve, që më provoi edhe një herë se çështja e pavarësisë së gjyqtarëve nga partitë politike është në thelb e njëjtë me çështjen e pavarësisë së gazetarëve.

Megjithatë, duke qenë se çështjen e pavarësisë së Drejtësisë e konsideroj më të rëndësishmen për momentin, po e rimarr edhe një herë temën duke replikuar me ato argumente kundër propozimit tim, që më duken të rëndësishmet.

Së pari, dua të ve në dukje se thelbi i shkrimit tim nuk ishte thirrja për t’i ngritur rogat prokurorëve dhe gjyqtarëve, por thirrja për të çliruar Drejtësinë nga “prangat ekonomike” – siç komentonte një lexues, – ku propozimi për rogat merrte një vlerë përtej shumës së parave që propozoja. Le të ndalemi pak këtu. Kam ngulmuar dhe ngulmoj se pas vitit 1997 sistemi i ndërtuar në Shqipëri, që shumë e kanë quajtur herë oligarki, herë kleptokrati,

herë shkërdhatokraci, herë klientelokraci, herë postdemokraci, por kurrë demokraci, e ushtron sundimin e tij jo nëpërmjet burgjeve, as nëpërmjet policisë apo shërbimeve sekrete, por nëpërmjet “prangave ekonomike”. Nuk ka pikë dyshimi se këtyre prangave i shtohet edhe injoranca, edhe shpëlarja e truve, por, kur bëhet fjalë për elitën, ku do të hynin pa dyshim edhe prokurorët e gjyqtarët, elementi kryesor janë prangat ekonomike.

Çfarë e karakterizon këtë sistemin tonë të prangave ekonomike, që është sui generis në egërsinë e tij, siç ka qenë edhe komunizmi ynë? Në një rreth vicioz, ky sistem më një anë ka vendosur në qendër të vet paranë jo vetëm si nevojë mbijetese, por edhe si të vetmin burim lumturie dhe, më anë tjetër, duke mos krijuar dot mundësi që ta shpërndajë atë në mënyrë të ligjshme, i shtyn njerëzit drejt korrupsionit, kriminalitetit etj. Me fjalë të tjera, në një rreth vicioz, sa më shumë nevojë për para kanë njerëzit në këtë sistem, aq më shumë shtyhen në krim e paligjshmëri.

Kur bëhet fjalë për Drejtësinë, në terma thjeshtëzues do të thuhej se prokurorët dhe gjykatësit tanë janë përpara alternativës: ose të mjaftohen me rrogën që nuk mund t’u kënaqë as nevojat e tyre materiale dhe jo më ato të “lumturisë”, ose të shiten te mafia dhe krimi që i paguan shumë më tepër. Shumica ka bërë zgjedhjen e dytë, çka implikon edhe korrupsionin e tyre nga politika, pasi marrja e një vendi të tillë pune në sistemin tonë klientelar për shumicën nënkupton të kesh dorën e ngrohtë të partisë. Kur arrijnë në këtë pikë të analizës së realitetit tonë, të gjithë i kap dëshpërimi, duke të thënë se të gjithë kanë bërë këtë zgjedhje, duke filluar që nga Presidenti dhe Kryeministri, e duke shtuar: mirë prokurorëve e gjyqtarëve, po administratës, po deputetëve, po policëve, po mësuesve, po mjekëve, a nuk u duhen rritur rogat, dhe ku t’i gjejmë këto para? Dikush më ka kujtuar se edhe vetë kam shkruar se këtu bëhet fjalë për një flotë që duhet të ecë e tëra, jo për një anije të vetme që shkëputet përpara. Dhe më në fund kryeargumenti kundërshtues është ai se çfarëdo rroge t’u vësh gjyqtarëve dhe prokurorëve, kjo s’mund

t’i çlirojë nga varësia prej politikanëve që i emërojnë, që me ndryshimet kushtetuese i kanë bërë edhe më të varur nga pushteti i politikanëve.

I quaj shumë të rëndësishme këto kundërgjegjësi. E quaj shumë të rëndësishëm edhe argumentin se një ndryshim i madh do të vinte nga ndryshimi kulturor: d.m.th. kur në sistemin e vlerave të njerëzve nuk do të siguronte vetëm paraja, por edhe vlera të tjera të ashtuquajtura “shpirtërore”, që te prokurorët dhe gjyqtarët do të përktheheshin, veçanërisht, në dashuri për drejtësidhënie dhe krenarinë e të qenit i drejtë.

Por, në këtë pikë unë shtroj pyetjen: a duhet filluar diku? A po themi se një nga këqijat më të mëdha që na lë prapa është konfliktualiteti i dy bandave dhe korrupsioni i tyre, si dy anë të së njëjtës medalje: a po flasim përditë për reforma: a kemi një prezencë ndërkombëtare që asiston Shqipërinë në rrugën e saj drejt demokracisë, me fjalë të tjera, a shpenzohen përditë energji për ta ndryshuar gjendjen? Askush nuk e mohon dot këtë, ndonëse, ç’është e vërteta, shumica janë të mendimit se ajo që bëhet është një teatër, sipas të cilit, lëviz gjithçka për të mos ndryshuar asgjë. Por, s’mund të mohohet, po ashtu, se e gjithë kjo klimë e imponon nevojën e një Drejtësie të pavarur edhe atyre që më pak se kushdo do ta donin një gjë të tillë, siç janë politikanët tanë.

Kujtoj me këtë rast se fakti që me ligj në sistemin ku jetojmë ndarja e Drejtësisë nga pushtetet e tjera është parim themelor, e prandaj askush nuk guxon ta kundërshtojë, e lehtëson këtë punë. Ndërkohë që po shkruaja këto radhë, lajmet e TV Klanit transmetuan një akuzë të rëndë, se një biznesmen i lidhur me socialistët paska shtyrë/paguar disa nga ata njerëz që kanë bërë dhunë më 21 janar të hedhin në erë shtyllat e tensionit të lartë në Lezhë, për ta futur vendin në terr ditën e 31 janarit. Nëse është kështu, krimi është shumë i rëndë; nëse nuk është kështu, ky lajm të kujton akuzat e fabrikuara për sabotim në kohën e Hoxhës. Kush do ta ndajë të vërtetën: të dënojë fajtorët për sabotim, apo fabrikuarit për fabrikim akuzash të rreme? Apo do të vazhdojmë me akuza ekranesh që i shërbejnë vetëm teatrit elektoral të partive, apo me pretendimin se Drejtësia na sigurohet kur këta kontrollojnë njëri-tjetrin? Unë them se jo. Këta duhet të gjejnë urgjentisht rrugët për t’ia lënë këtë pushtet Drejtësisë së pavarur prej tyre. Siç shkruaja edhe në shkrimin paraardhës, njerëzit janë tejtjergopur dhe me këtë teatër, dhe ka ardhur koha të fillohet diçka serioze, që vërtet të ndryshojë diçka.

Le të rendis disa arsye shtesë nga ato të artikullit paraardhës pse, sipas meje, çlirimi i njerëzve nga sistemi i “prangave ekonomike”, që, e përsëris, nuk janë të vetmet, duhet të fillojë nga Drejtësia. Së pari, sepse puna e prokurorit dhe gjyqtarit është e një përgjegjësie sipërore në mbarëfunksionimin e shtetit dhe të një shoqërie. “Një vendim i padrejtë (gjyqësor), – thotë Francis Baconi, – bën shumë herë më keq sesa shumë shembuj të këqij,

sepse nëse këta ndotin lumin, ai ndot vetë burimin”.

Së dyti, sepse ekonomikisht, nëse një mjeku, një mësuesi, qoftë edhe një njeri të administratës mund t’ia pranosh (duke pasur parasysh vështirësitë), edhe një punë të dytë me të cilën të plotësojë rrogën, është e vështirë që një prokurori apo një gjyqtari t’i thuash të gjejë kohë të hapë një aktivitet tregtar.

Së treti, sepse numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve është më i vogël në numër sesa ai i mësuesve, mjekëve, njerëzve të administratës etj., etj.

Në një koment të tij mbi shkrimin tim, një lexues që dukej se ishte njeri i së drejtës, pasi thoshte se “kursesi nuk mund të presësh të marrësh drejtësi nga dikush që nuk ka mjetet për ta dhënë atë, që janë minimalisht statusi i gjyqtarëve/prokurorëve: duke përfshirë, garancitë ekonomike, sociale deri edhe fizike për ata dhe familjen e tyre”, shtonte edhe faktin se në raportin e EURALIUS-it është thënë prerazi që para 4-5 vjetëve, se: “Është e rrezikshme për sistemin e drejtësisë shqiptare të ketë paga më të ulëta se 1000 euro në muaj për gjyqtarët dhe prokurorët e shkallës së parë”.

Përsa i përket argumentit – shumë serioz – se edhe një gjyqtar apo prokuror i mirëpaguar mund të mbetet i varur e në shërbim të politikës, unë gjej se nëse akti i mirëpagimit do të shoqërohej me disa rregullime shtesë në ligj, që do ta bënin zgjedhjen e gjyqtarëve edhe më të pavarur nga ç’është prej politikës, do të rritej shumë më tepër mundësia që Drejtësia të varet te ligji, dhe jo te partitë politike.

Si përfundim, duhet pranuar se “malli” që marrim ne prej njerëzve të Drejtësisë nuk është i krahasueshëm as me ushqimet që blejmë në treg, as me cilësinë e mësimeve në shkollë, as me atë të shërbimeve mjekësore dhe as me atë të shërbimeve gazetareske, politike apo administrative. Të gjitha këto që përmenda janë tejet të rëndësishme, pa dyshim, por për të gjitha ato mund të flasësh për procese përmirësimi që vijnë me kohën. Për të gjitha ato mund të flasësh edhe për “blerjen” e tyre “sipas takatit”, pra, për ushqime më cilësore dhe më të dobëta, për mësues më të zotë dhe më pak të zotë, për gazetari më profesional dhe më pak; edhe shërbimin e politikanëve e të administratës mund ta relativizosh, por kursesi Drejtësinë. Sepse ajo, sikurse liria, është e drejtë themelore që ka të bëjë me thelbin e jetës, para së cilës duhet të ndjehen të barabartë të gjithë, të pasur dhe të varfër, të fortë dhe të dobët, kriminelë dhe të ndershëm. Prandaj dhe për këtë “mall” duhet të paguajmë më shumë se për çdo mall tjetër. Dhe jam i bindur se do të ketë shumë prokurorë dhe gjyqtarë që do ta ndiejnë peshën e përgjegjësisë që do t’u jepte një akt i shoqërisë që do t’i vendoste ata në qendër të shpresës për të ndërtuar një shoqëri të drejtë.

Një thënie arabe thotë: “Mjerë ata breza, gjyqtarët e të cilëve meritojnë të gjykohehen”. Ka disa breza shqiptarësh që e vuan këtë mallkim. Është koha për të thënë mjaft.

Pse Europa heshtë problemin e shqiptarëve të Greqisë (Çamërisë)?!

Nga: Ilir Berisha

Brenda gjirit të kufinjëve të saj të BE-së egzistojn shumë probleme të cilat i heshtin sikur mos të egzistojn ato. Problemi i Baskëve në Spanjë, Irlandezve në Mbretërinë e Bashkuar Angleze i shqiptarëve të Greqisë, Çamërisë janë fiksime i pasojave Europiane që mund të eskalojnë situatën politike Brenda BE-së. Vetë politika e BE-së po i financon shtetet për heshtjen e këtyre problemeve egzistuese që donë zgjidhje.

Për kundër problemeve ekonomike që ka kapluar sistemin kapitalist European, të shteteve Brenda BE-së të cilat kanë edhe probleme politike në vendet e tyre. Nuk mund të heshten këto probleme më. Të cilat janë pasojë e shteteve për teritore të nënshtruara me etnitete tjera brenda shteteve të cilat kërkojnë



mevetësi dhe vetëvendosje për të drejtat e tyre lirit dhe vetëqeverisje

.Në teritoret e tyre etnike, gjuhesore dhe kulturore. Të gjitha këto janë të

shkruara në ligje dhe karta garantuese të shteteve dhe të drejtave të popujve në OKB dhe institucione relevante udhëqese botërore. Të gjitha shtetet thirren në paqe në solidaritet për paqe kundër shtypjes së popujve, kundër sistemeve të dhunshme politike që cenojn lirit dhe të drejtat e popujve por sa janë këto shtete brenda sistemeve të tyre liberale dhe demokratike e paqesore në këtë drejtim?

Shum pak deri sa ekonomia është ajo e cila përcakton shtrirjen e politikave diskriminuese ndaj masave të caktuara shoqërore nuk do të ketë stabilitet ekonomik e as politik në Europë e as BE. Shumica e shteteve janë krijuar si pasojë e shtypjes dhe dhunës ndaj një pjese të popujve dhe teritoreve Brenda përbërjes së tyre me anë të luftërave gllabëruese. Duke zbatuar Brenda tyre sisteme diktatoriale shtypëse me ligje e nene diskriminuese ekonomike gjuhsore etnike kulturore.

Greqinë e krijuan shqiptarët Arbanitasit por e nënshtruan sllavët me dhunë e falcifikuan historin realitetin, futën përçarjen Brenda

luftë fetare në mes ortodoksëve Arbanitasve dhe shqiptarëve musliman duke e mohuar identitetin e tyre Ilir Pellazg Shipëtarë dhe duke bërë shpërngulje massive prej teritoreve të tyre të Çamërisë.

E kjo u bë në sy të botës së qytetëruar e të civilizuar Europiane nëse mund ta quajm kështu.

Që sot pasardhësit e tyre shqiptarë nuk lejohen të rikthehen në trojet e të parëve të tyre?!

Një grusht sllavesh me politiken e tyre raciste e mban të robëruar me opiumin sllavo kishtar ortodoks të Greqinë Shqiptare dhe Çamërinë të okupuar. Për interesat e këtij klani të cilët po i mban të financuar BE-ja. Duke e stimuluar krimin përmbi shqiptarët Arbnitasit në tërë Greqinë.

Europa dhe sllavët i kanë borgjë shumë të madh shqiptarëve në pergjithësi e shqiptarëve të Çamërisë në veçanti. Çamëria një ditë do të Agoj, Gdhihet e lirë, dita po afron.

Europë ndal genocidin tuaj dhe atë sllavë ndaj Çamërisë se durimit i ka ardhë fundi.

Shkoder: Shpërthim dinamiti në familjen Mashku, pa viktime

Një shpërthim i fuqishëm ka zgjuar banorët e rrugës "Zenelaj" në lagjen "Ahmet Haxhia" të qytetit verior Shkoder, në orët e para të mëngjesit të datës 7 shkurt 2016.

Sipas burimeve të para një sasi prej 200 gramësh dinamiti ka shpërthyer në oborrin e banesës së Sami Beqir Mashku. Në atë kullm shtëpie banojnë dy familje Sami Mashku me gruan Remzie Mashku dhe familja e të birit Elvin Sami Mashku me gruan Elsona Mashku dhe djalin e tyre Enes Mashku.

Shpërthimi ka shkaktuar dëme material tek pjesa e përparme e murit, afër derës, por pa viktime në njerëz.

Ngjarja e rëndë ka ndodhur rreth orës 04 e

10 minuta të datës 7 shkurt 2016, ku persona të paidentifikuar, kanë hedhur lëndën plasëse e janë larguar me shpejtësi nga vendngjarja. Sipas bisedës me një specialist të kriminalistikës, akti është terrorist dhe personat që kanë lëshuar lëndën plasëse kanë llogaritur gjatësinë e fitilit zjarrpërcjellës që të kenë kohë të mjaftueshme të largohen derisa shkëndija të shkojë tek kapsolla detonatore. Mësojmë se familja Mashku megjithëse e besimit musliman, ka frekuentuar prej shumë vitesh kishën katolike dhe ekstremistë të besimit musliman kanë qënë të acaruar me veprimet e tyre. Ata e kishin paralajmëruar disa here këtë familje që të falet pese here dite dhe të shkojë në xhami,

ndryshe do i vrisnin. Në fakt, një vit më parë terroristët i vëndosën tritol edhe familjes së babait të ministrit të brëndshëm Saimir Tahiri, farmacistit Bashkim Tahiri dhe ende nuk janë dënuar terroristët.



Edhe ky rast me dy familje në Shkodër të Sami Mashku dhe Elvin Mashku, babe e bir, ka patur ndikim negative tek qytetarët e Shkodrës, pasi që atë natë dy familjet janë detyruar të lëshojnë banesën e të jetojnë në ilegalitet. Qytetarët e thjeshtë nuk e kanë kursesi mundësinë të përballojnë ngjarje të tillë atë rënda. Familja e ministrit dhe e babait të tij edhe sot janë nën mbrojtje nga organet secrete të Policisë së Shtetit, ndërsa rasti në fjalë i familjeve I dy familjeve shkoderane dhe i gjithë viktimeve pa faj të terrorit islamik, duhet përballuar vetë. Përfundimet janë fatale. Ose vriten, ose jetojnë në ilegalitet. Vetëm në 20 vitet e fundit, sipas gazettes Corriere della Sera, në Shqipëri janë vrarë mbi 20 000 shqiptarë të pafajshëm.

Redaksia

Malesi e Madhe: Konflikti për pronat, vritet Rrok Arra

Problemet e pronësisë po marrin shumë jetë të pafajshme njerëzish. Është kjo plaga më e rëndë e shoqërisë shqiptare. Ky fenomen është më i theksuar në Veriun e Shqipërisë, çka ka regjistruar edhe numrin më të madh të viktimeve. Mbrëmjen e djeshme fshati Hot u përgjak nga një konflikt për pronën, ku Lek Celaj, banues i fshatit Hot ka qëlluar për vdekje me armë zjarri shtetasin Rrok Arra, banues i fshatit Dukagjin. Ngjarja e rëndë me një të vdekur, ka ndodhur në një lokal në fshatin Hot, jo më larg se dy kilometra nga Dogana e Hanit të Hotit. Nga informacionet e shpejta, gazeta jonë mëson se në atë vend nipat e vrasësit Lek Celaj kishin ndërtuar një lokal, dhe vrasësi dhe viktime kishin patur një konflikt pronësie.

Mbrëmë konflikti ka degjeneruar deri në vrasje, ku Lek Celaj vrau me armë zjarri të quajturin Rrok Arra.

Efektivët e policisë janë lajmëruar dhe kanë ardhur shumë shpejt në vëndin e ngjarjes, të shoqëruar edhe me ambulancën e spitalit rajonal. Ambulanca ka marrë trupin e pajetë të shtetasit Rrok Arra, ndërsa policia shoqëroi për në komisariat disa persona të përfshirë në konfliktin e pronësisë. Behet me dije se autori i krimit është i armatosur dhe ka arritur të largohet në drejtim të paditur. **Redaksia**

BE, 1,2 milion euro shoqërisë civile në Shqipëri

Bashkimi European mbështet organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri nëpërmjet Programit TASCO

Zyra e Programit TASCO në Tiranë ka zhvilluar para pak ditësh në Shkodër një sesion informues në kuadër të thirrjes për propozime nga Instrumenti European për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) dhe Skema e Mbështetjes me Grante për Shqipërinë për vitet 2012-2013 në lidhje me procedurën e aplikimit për grante të BE-së në kuadër të fondeve të EIDHR 2012/2013. Kishte një pjesëmarrje cilësore të organizatave të shoqërisë civile si dhe të pushtetit lokal të Shkodrës dhe Lezhës. Sipas Drejtorit të Projektit TASCO Albania, Genci Pasko:

"Bashkimi European funksionon mbi bazën e demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe për këtë qëllim, për t'i standartizuar këto parime ka futur të gjithë asistencën dhe zbatimin e projekteve të huaja në vlerat e këtyre komponentëve që përmenda. Më konkretisht, duke filluar nga viti 2000, BE ka instrumentalizuar një instrument të posaçëm që quhet instrumenti european për demokracinë dhe të drejtat e njeriut, qëllimi i të cilit është mbështetja me projekte e atyre organizatave të cilat kanë si mision kryesor të tyre luftën kundër diskriminimit të të drejtave njerëzore. Ka një buxhet global i cili shkon në total prej 600 milionë eurosh për periudhën 2007-2013, i cili u shpërndahet në formën e granteve rreth 90 vendeve të botës përmes delegacioneve përkatëse të Bashkimit European."

Duke u ndalur konkretisht në vëmendjen e

BE-së ndaj Shqipërisë si dhe në statusin e saj aktual, Pasko theksoi: "Normalisht që Shqipëria nuk bën pjesë në ato vende ku të drejtat e njeriut shkelen dhe nëpërkëmben në mënyrë drastike por përsëri opinioni i BE-së për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin European sikurse edhe progres-raportet përsëri kanë evidencuar raste specifike të abuzimit me segmente të caktuara të drejtave të njeriut. Për të luftuar këto fenomene dhe për të stimuluar një trajtim më të barabartë të të gjitha shtresave, sapo është celur nga Delegacioni i BE-së në Tiranë Njësia për Propozime në shumën prej 1,2 milion euro. Te kjo shumë do të mbështeten organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri të cilat, në bashkëpunim me institucionet vendore janë të ftuara të aplikojnë për projekte të cilat do të adresohen në 3 fusha kryesore: Projekte në mbështetje të grave dhe të eliminimit të dhunës ndaj tyre, projekte që synojnë eliminimin e keqtrajtit të fëmijëve si dhe konsiderimin e barabartë edhe të shtresave të tjera me orientime të ndryshme seksuale, duke përfshirë këtu edhe komunitetin LGDB. Ndërsa në mbyllje të prononcimit të tij, duke folur për vëmendjen e këtij Projekti në rajonin Verior të Shqipërisë në Shkodër, Drejtori i Projektit TASCO, Genci Pasko tha: "Për t'i ardhur në ndihmë organizatave të qarkut të Shkodrës dhe të Lezhës, Projekti TASCO, Zyra e Shqipërisë po intervenon nëpërmjet shpjegimit të kriterëve të aplikimit për këto thirrje në mënyrë që të rritet numri i propozimeve për organizatat përfituese si dhe të rritet cilësia e shkrimit dhe e përgatitjes së tyre. Organizatat e Shoqërisë Civile do të gjejnë

përherë mbështetje për projekte dhe programe në kuadër të thirrjeve të ndryshme për propozime të shpallur nga Bashkimi Evropian."

Gjatë kësaj sesiioni informues pjesëmarrësit u njohën me Udhëzuesin e Thirrjes për Propozime, Formatin përkatës të Aplikimit, përgatitjen e buxhetit të projektit, kriteret e cilësisë së projekteve të financuara nga BE, etj. Gjatë kësaj sesiioni është kombinuar puna teorike me atë praktike në formën e prezantimeve të shkurtra, shkëmbimit të përvojave ndërmjet OJF-ve të ndryshme për të siguruar përmirësimin e objektivave të Projektit TASCO. Roli i Projektit TASCO (Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile) në Shqipëri në rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile për të përfituar nga fondet e Bashkimit Evropian ka fituar një vlerësim të konsiderueshëm ndërmjet shoqërisë civile. Kjo mbështetje është dhënë që me fillimin e zbatimit të Projektit në Shqipëri në gusht 2009 duke i qëndruar pranë nevojave të organizatave me organizimin e cikleve të plotë trajnuese, seminarëve e sesiioneve informuese.

Këto evenimente janë organizuar pikërisht ndërsa thirrjet për propozime nga BE ishin ende të hapura duke rritur kështu në praktikë nivelin e cilësisë së projekteve, por edhe numrin e aplikimeve. Projekti TASCO - Asistenca Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile - është një projekt rajonal i financuar nga Bashkimi Evropian që ka nisur zbatimin në vitin 2009 e që po zbatohet paralelisht në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e Turqi.

ARBEN LAGRETA

Vlerësimi real i njeriut, moment i rëndësishëm në jetën e një vendi



Nga Arjan Th. Kallço
Pedagog në Universitetin
Fan S.Noli, Korçë

Të vlerësosh një njeri sot mbi bazën e kritereve të vërteta, të paanshme dhe reale, është një nga detyrat më imediate të vendit tonë. Në gjithë këto vjet, të verbuar nga urrjetja politike mes të ngjashmëve, të paktën demokracia nuk duhet të pranonte të tilla, vlerësimi i njeriut është barazuar me zero. Po vlerësojmë gjithçka të shkuar, me një sulm të pasohq kolektiv, sikur të gjitha mëkatet t'i kishte e kaluara dhe sulmi ndaj të gjitha problemeve të sotme, ka kohë që nuk ndihet më. Edhe kur fillon ndonjë tentativë, mbytet me kthim në të shkuarën.

A thua se e shkuara do të mund të ngjallet më? Dhe në u ngjalltë, për shumë anë të ngjashme, thonë se historia përsëritet, mos ndodhtë një gjë e tillë, sulmet do të drejtohen gjithmonë ndaj sistemit, regjimit dhe njerëzve që e kanë përfaqësuar atë. Pra, si me thënë sulmo të shkuarën që të të sulmojnë kur të jesh larg së sotmes. Si gjithmonë, në krye të këtyre shtrëmbërimeve të vlerësimit është politika, pasi nuk e pranon dhe nuk e bën dot vlerësimin e drejtë të njeriut. Po dëgjojmë dhe

lexojmë sot për vlerësime tepër superlative, sikur në Shqipëri gjithçka të shkojë vaj dhe të jemi fanari i dikurshëm i ndriçimit për botën. Por tallja më e fundit është bumi i vlerësimit nëpër shkolla dhe universitete. Aty nga fillimi i vitit universiteti i Tiranës, merr një nismë dhe shpërndan formularë, që më pas të mbushen nga studentët. Mesa duket disa mendësi për dosje ende janë të freskëta në mendjen e njerëzve, që kurrë nuk kanë vlerësuar njeriun e mirë. Më pas lajmi mori dhenë, pasi këto formularë ishin gati dhe studentët kishin ngelur në klasë pedagogët.

A është i nevojshëm një vlerësim i tillë? Mendoj se për shumë arsye nuk duhej menduar dhe vlerësuar kështu profesori i universiteteve. Por mesa duket edhe në përzgjedhje ka ndonjë gjë që nuk shkon, prandaj dosjet janë gati.

E para: situata tejet e rënduar në vend, dhe kjo përsëri për faj të politikës, nxjerr në pah faktin e dosjeve për pedagogët dhe më pas tundjen e tyre, kur të lindë mosbindja civile nga ndërgjegjësimi, nëse kjo do të ndodhë një ditë. Uroj që të ndërgjegjësohen të gjithë se shkolla nuk ka kusure politike për të larë, por vetëm mision fisnik.

E dyta: A mund të vlerësojë studenti pedagogun? Nuk e di nga cilat mendje djallëzore del kjo nismë, por është tepër dashakeqe, pasi do të mbahen peng universitetet dhe detyrat e tyre për dije dhe kulturë. Pra, nuk do t'i jepet liri universitetit të udhëheqë shkencën dhe kulturën, por duhet të pranojë pa kushte diktatin e politikës dhe reformat e çmendura të saj. Mjaft të kujtojmë se Ministria përsëri ndryshoi maturën shtetërore dhe menjëherë pas deklarimit të kryeministrit për dështim në reformën arsimore. Një qeveri me mend, kur dështon në këtë mision e saj më sublim, duhet ta kuptojë se ka dështuar në të ardhmen

e e një vendi dhe rruga e vetme është largimi i qytetëruar nga qeverisja, pa pritur fundin e mandatit.

E treta: pedagogëve u jepen vlerësime nën presionin e fëmijëve me prindër të deklaruar politikisht dhe pasojat e një vlerësimi "të gabuar të tyre" do të merrnin ndëshkimin e duhur.

E katërta: këtij vlerësimi do t'i trembeshin anëtarët e partive në universitete dhe për pasojë do të zbatonin fill e për pe direktivat e partisë, duke e mbajtur larg profesoratin nga problemet e shumta të vendit.

A duhet pranuar një vlerësim i tillë? Tek takojta studentë që e kishin plotësuar këtë formular, nëse kjo ka ndodhur është bërë në fshehtësi, pa e deklaruar hapur, të cilët ishin venë vërtet në siklet, të paktën ata studentë që kanë sy e faqe. Ndoshta një pedagog mund të marrë, për servilizëm dhe frikën e një note, edhe vlerësimet maksimale, por cilët janë ata që po e vlerësojnë? Studentët e tij dhe këtu marrëzia duhet sheshit. Në Itali, të paktën në universitetin që kemi frekuentuar shpesh, nuk dëgjuam ndonjë "nismë të tillë". Mund të ketë në ndonjë vend tjetër, por zorr se mund të pranohet, pasi pedagogët janë ajka e shkencës dhe e kulturës dhe jo të tesoruar për një vend pune edhe sikur të mos e meritojnë atë. Refuzova energjikisht në bisedë një vlerësim të tillë nga studentët, për të vetmen arsye se nuk e pranoj një vlerësim të tillë. Mesa duket vlerësimit, që me plot gojë do ta quaja subjektiv, pasi jemi mësuar me vlerësime injorantësh dhe partiakë, nuk do i shpëtojnë edhe institucione të tjera. Zoti na ruajtë....

Të shpresojmë që të tjerët të mos bëhen pre e instrumentalizimit politik si shumë parardhës që vlerësimi merr vetëm një kah, anën partiake dhe me ne o kundra nesh.

Demokrati Anton Gjokaj i rrezikuar me jetë

Kanë kaluar disa muaj nga zgjedhjet e 21 qershorit 2015 për pushtetin vendor, të cilat u fituan përmes dhunes nga partia socialiste, pasardhëse e partisë komuniste. Ato zgjedhje ishin plot terror, dhunë e plumba. Njëri ndër viktimat e betejës për mbrojtjen e votes së lire është edhe demokrati Anton Sokol Gjokaj, lindur me datën 03 korrik 1996 në fshatin Pjetrosan të Bashkisë Malësi e Madhe. Ky person edhe sot është i detyruar të qëndrojë i fshehur, pasi bandat e pushtetit kërkojnë ta eliminojnë fizikisht. Anton

Gjokaj, një demokrat i njohur, i cili mbështeti kandidatin për kryetar Bashkie të Partisë Demokratike Anton Kokaj, gjatë fushatës së ashpër elektorale, u dhunua rëndë fizikisht nga bandat e Partisë Socialiste. Më datën 14 qershor 2015, një javë para ditës së votimeve dy persona të maskuar, banditë të partisë shtet, i kanë dalë befasisht në Bajzë të Malësisë së Madhe dhe e kanë rrahur, duke e lenë pa ndjenja dhe duke e paralajmëruar se do e vrasin nëse perkrah demokratët. Është mjekuar urgjent në Qendrën Shëndetësore Kastrat, dhe sot nga frika, jeton në ilegalitet. Ky demokrat që ka investuar për një shoqëri me të drejta e liri njerëzore, vjen nga një familje e persekutuar nga regjimi komunist i Enver Hoxhës. Axha i babait të tij, i quajtur Gjok Pjeter Gjokaj, është dënuar me burg

politik 30 vjet, në vitin e largët 1945. Nga fisi i tij, ka patur edhe të tjerë të dënuar politikisht dhe të internuar e me pasuri të paluajshme të sekuestruar.

Anton Gjokaj dhe prindërit e tij kanë dhënë kontribut në Partinë Demokratike shqiptare si aktivistë, por fatkeqësisht sot po vuajnë pasojat e hakmarrjes. Vrasjet politike në Shqipëri janë të shumta. Pikërisht këtu në Malësi të madhe, dhjetë ditë para zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2009, u vra me lëndë plasëse Kryetari i Partisë Demokratiane të Malësisë së Madhe, Aleksandër Keka. E vranë bandat e Partisë socialiste, pikërisht ato banda që dhunuan dhe kërcënojnë se do vrasin edhe të riun Anton Gjokaj.

Redaksia

Në Shqipëri ligjin e bëjnë bandat e drogës

Në vitin 1992, kur në Shqipëri u përmbys sistemi komunist, populli ëndërronte për një jetë të lirë e demokratike. Bandat e drogës krijuan lidhjet në çdo sektor të shtetit dhe të shoqërisë, bile duke i vranë ata që punuan për një shtet normal. Kështu ngjau edhe me ish punonjësin e policisë së Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) në Prefekturën e Shkodrës, te quajtur Y.D, të datëlindjes 14 maj 1978. Ai kishte marrë pjesë në disa operacione për shkatërrimin e parcelave me Cannabis Sativa dhe ishte i specializuar, ku kishte marrë edhe Vertetim Stazhi nga inspektorët e policisë franceze gjatë trajnimeve. Por, mafia e drogës, duke patur në Policinë e Shtetit informatorët e vet, merrte informacione. Y.D, ishte futur në rreth të kuq për tu vranë, pasi punonte me ndershmëri dhe nuk pranonte të bashkëpunoi me kultivuesit e drogës. Kështu i filluan presionet dhe në vitin 2006 u detyrua të braktisë punën në polici, thjeshtë për të shpëtuar jetën. Por kërcënimet më të rëndë i vjen në maj të vitit 2015 nga shtetasi Marjan Nikë Rripa, i cili i thotë ish policit Y.D se i ka shkatërruar një parcelë me drogë, duke i prishur biznesin. Si përfundim Rripa i ka përcaktuar dy rrugë ish policit Y.D. I ka thënë ose të paguajë dëmmin çdo muaj deri sa ta shlyejë atë, ose do të respektohet ligji i Kanunit, ku do ta vrasë bashkë me djemtë. Ligjet e Kanunit mesjetar të Lek Dukagjinit janë të zbatueshme edhe sot në Shqipëri. Pra, sipas Kanunit, Rripa ka ngujuar vetëm Y. D. dhe djemtë e tij, që do të thotë, duhet të rrinë brënda e të mos dalin nga Kulla e Ngujimit. Mësojmë se ish polici ka filluar të lëvizë me shumë kujdes, por një ditë, pikërisht më datën 19 gusht 2015, rreth orës 15:00, në lagjen "Vojo Kushi" të Shkodrës, afër Radio Shkodrës, ish polici Y.D. dhe kultivuesi i drogë Marjan Nikë Rripa, janë ndeshur papritmas ballë për ballë. Rripa i ka thënë: "Kaq trim je sa lëviz në qytet, nuk respekton ligjin e Kanunit e nuk rri i ndrymë brënda" dhe ka nxjerrë thikën dhe ia ka ngulur në krahun e majtë, diku afër zemrës, për ta vranë. Dëshmitar në vëndin e ngjarjes ka qënë shtetasi Gezim Çelepia. Pas ngjarjes së rëndë, kriminelit është larguar i qetë, ndërsa viktimat ka përfunduar në spitalin rajonal të Shkodrës, ku për fat dhe falë kujdesit të specializuar të mjekëve, nuk ka patur probleme për jetën.

Ngjarjet kanë lëvizur për keq, pasi megjithëse kriminelit u denoncua në Prokurori dhe dosja e tij i kaloi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ai doli me një masë dënimi minimale. Pas kësaj ngjarjeje, tentativë për vrasje, që tronditi qytetin verior, ish polici Y.D u detyrua të jetojë i fshehur dhe ka disa kohë që askush nuk ia di adresën. Është zhdukur për të shpëtuar jetën. Tashmë jeta e tij dhe e djemve të tij është futur në rreth të kuq për tu vranë.

Redaksia e gazetës

Terrorizmi islamik në Shqipëri i ka bazat që në vitin 1989

Ishin lëkundur fort themelet e diktaturës komuniste. Kishin nisur protestat në Shkodër e Kavajë dhe ata pak priftërinj që kishin shpëtuar te gjallë si Dom Simon Jubani, Çesk Ashta, Mikel Koliqi, Ernest Troshani e ndonjë tjetër, po organizonin besimtarët për mbajtjen e meshave pas një periudhe të gjatë që diktatura komuniste kishte nxjerrë jashtë ligji besimin fetar. Kane qënë Rin Monajka, Aleks Keka, Vitor Pukri që në veri të Shqipërisë ishin krah priftërinjve për të rikthyer besimin

fetar. Këtu nisen edhe përplasjet e para jo vetëm me sistemin komunist, por edhe me elemente terroristë islamik. Duke shfrytëzuar varfërinë, në vitin e largët 1989, elementë terroristët paguheshin për të krijuar situatë terrori. U kërcënuan me jetë të rinjtë Rin Monajka, që me vonë është vranë, Aleks Keka, edhe ky i vranë më vonë, u kërcënuan me jetë edhe Vitor Pukri, që kaloi shumë peripeci dhe ka disa kohë që nuk ka adresë, nga frika reale se terroristët do e vrasin. Vrasja me tritol në makinën e tij e Aleks Kekës, e cila shpërtheu në vitin 2009, u deklarua nga Kryetaria e Parlamentit Shqiptar të asaj kohe Jozefina Topalli, si vrasje fetare, si akt terrorist islamik



dhe strukturat e shtetit as sot e kësaj dite nuk kanë hetuar, çka flet për mbështetje politik të elementëve terroristë. Vitor Pukri kaloi peripeci e terror me jetën dhe më 27 shtator 2008 vëllait të tij, të quajtur Filip Pukri, në vëndin e quajtur "Harku i Bërdicës", rreth dy kilometër larg qytetit verior të Shkodrës, i ka ndodhur një kërcënim me jetë nga H. Shqau, i cili në emër të All'ahut i ka thënë se do e vrasë, nëse nuk i tregon adresën e të vëllait, Vitor Pukri. Që aso kohe e deri sot, që kanë kaluar afro 7 vjet e gjysëm, fisi Pukri ka lënë shtëpitë bosh dhe të gjithë kanë marrë rrugët pa rrugë për të shpëtuar jetën. Janë larguar nga Shqipëria. Mësojmë se janë bërë denoncime në

shtet dhe ndërhyrje tek Shoqatat Mbarëkombëtare të Pajtitit të Gjaqeve, por pa asnjë rezultat. Shteti jo vetëm është i pafuqishëm, por edhe pasi shërbimet e huaja perëndimore kanë arritur të arrestojnë mbi 20 terroristë islamikë, kryesisht imamë që kanë rekrutuar luftëtarë të ISIS për në Siri dhe me gjithë faktet që ndërkombëtarët kanë paraqitur, gjykatat shqiptare, por edhe ato kosovare, po vonojnë hetimet, duke i zvarritur pasfundësisht.

Është një gjendje vërtet e rëndë, ku terrorizmi islamik është i instaluar edhe në strukturat e shtetit e të policisë, si duket me qëllim për ta mbajtur të fortë korrupsionin dhe shtypjen e të drejtave e lirive njerëzore, duke e renditur Shqipërinë e vogël shtetin që për nga popullsia zë vëndin e parë në Botë si furnizuese me luftëtarë të organizatës terroriste ISIS, në Siri.

Redaksia

Shën Shtjefni, pesë shekuj “endacak” në Shkodër

Më 1479 Shkodra kishte 405 burra dhe 105 gra

Përpara se të justifikojmë titullin e shkrimit tonë, ne po rikujtojmë se Shën Shtjefni (apo Shën Stefani) ka qenë i pari i zgjedhur nga 12 apostujt e Jezu Krishtit, në mes shtatë nxënësve të tyre, ku u zgjodh më i miri, më i urti, i mbushur me Frymën e Shenjtë, duke vendosur dorën mbi këtë, si simbol i kalimit të pushtetit shpirtëror në të shungurueshmin.

1. Siç dihet Shën Shtjefni u bë shenjt me predikimet e tij të cilat ja kushtonte Hyjit e Jezusit që ai edhe në momentet e mbytjes së tij me gurë, i drejtoi sytë nga qielli dhe tha: “Qe, po e shoh qiellin e hapur dhe birin e njeriut në të djathtë të Hyut.”

2. Duke ditur se Ilirët ishin ndër të parët që përqaftuan pa mëdyshje Besimin Kristian, madje në kundërshtim me urdhërat e perandorisë Romake pagane të asaj kohe, ne nuk kemi përse dyshojmë se edhe kulti i Shën Shtjefnit ka ardhur në trojet tona që në shekujt e parë, pas njohjes së mrekullive të këtij shenjtori. Kulti i Shën Shtjefnit kishte një përhapje të gjërë edhe sipas modelit bizantin, ku në kishën e Shën Stefanit (Shën Shtjefnit) të Kostandinopojës janë kurorëzuar e martuar në shekujt e V – VIII Perandorët e perandorisë Romake të lindjes. Lavdia e këtij shenjtori depërtoi shpejt në të gjitha provincat, deri në Afrikën e Veriut, por edhe në Dalmaci, ku janë ndërtuar prej Shkodrës deri në Raguzë shumë kisha kushtuar këtij shenjtori. Lidhjen e tyre me këtë Patron shkodranët e shprehin duke u vënë djemve të tyre shpesh e me dëshirë emrin Stefan (Shtjefen).

3. Kalaja dhe qyteti i vjetër (në Kala dhe Varoshi) është vërtetuar se ka të paktën një histori rreth 2400 vjeçare, por ne po u referohemi disa materialeve post kristiane që tregojnë për hershmërinë e ndërtimit të Kishës së Shën Shtjefnit në Kalanë e Rozafës. Mund të kenë qenë ndërtuar në mes bazilikave të lashta të shekujve IV – VI dhe kishave të mapastajme Romako – gotike, dhe manastireve benediktine edhe katedralja e Shën Shtjefnit në Shkodër dhe janë të gjata 20-30 metra dhe të gjëra 9-10 metra.

4. Kisha kryesore e Shën Shtjefnit e ndërtuar në veriperëndim të Malit të Kështjellës përbëhej nga një anijate me një absidë drejkëndore të brendshme e të jashtme. Muret ishin prej blloqesh të vogla kuadratoke e të gdhendura pastër. Një fazë e parë e ndërtimit datohet në shekullin XII (me siguri ka të bëjë me ndryshimin e kësaj kisha nga e

oritit Katolik në atë të rritit ortodoks. Një periudhë e dytë e shekullit XIV ndërthuri në mënyrë më të thellë elementet gotike.

5. Duke vazhduar “rrugën e dokumentave të pasqyruara në libra apo materiale të tjera që tregojnë për Kishën e Shën Shtjefnit në Kalanë e Shkodrës dhe lidhjet e qytetit me këtë shenjtor ne mësojmë se: Statusi i Shkodrës na vlen si një udhërrëfyes i saktë. Ditën e Shën Markut me 25 prill këmbanat e Shën Shtjefnit thërrisnin në Shkodër popullin dhe Ipeshkëvin si dhe katër fisnikë. Kjo asamble zgjedhte tre gjykatës, tetë anëtarë këshilli dhe dy arkëtarë. Secili prej të zgjedhurve duhej të merrte funksionet brenda tre ditëve. Periudha e ushtrimit të funksionit zgjaste një vit.

6. Edhe më i rëndësishëm dhe mbresëlënës për shqisat ishte nderimi i Patronit të qytetit. Padyshim gati

torit e bashkë me të edhe të qytetit të lidhej me të.

7. Siç dihet, në qytetet dhe fshatrat e Arbërisë së veriut, ku dominonte besimi kristian i rritit katolik, kishte një larmi të nderimit të shenjtorëve. Vetëm në malin e Kështjellës së Shkodrës kishte Katedralen e Shën Shtjefnit, Shën Mërisë dhe Shën Vlashit. Në kalendarin kishtar të Shkodrës dilnin veçanërisht në pah prej statutit të kremtimeve, ato për Shën Sergjin e Bakun, Shën Markun 25 prill, (njëkohësisht dita e asamblesë), Shën Pjetrin 29 qershor, Shën Elin me 20 korrik, Shën Shtjefnin me 2 gusht dhe 26 dhjetor.

8. Është me vlera të thuhet se qytetet Arbnore që kishin punishtet e prerjes së monedhave, vazhdimisht paraqitnin në njërën anë “fytyrën e Patronit të qytetit të tyre. Kur ndër këto qytete po cilsojmë: Tivarin, Ulqinin dhe Shkodrën që kishin punishtet e veta për

dik.

10. Kjo vërtetohet lehtë nëse lexojmë DEFTERIN E REGJISTRIMIT TË SANXHAKUT TË SHKODRËS të vitit 1485, pra vetëm 6 vite pas pushtimit të Kalasë e qytetit të Shkodrës, gjejmë të regjistruara në faqen 135 të defterit vetëm 26 shtëpi muslimane (ata që sot i quajmë me të vjetrit qytetarë me origjinë nga Egjipti), dhe në faqen 136 të këtij defteri janë të shkruara 23 shtëpi (në përmbledhëse shkruhet me shifra gabim 33 shtëpi) të Krishtera, por të gjitha janë të rritit Ortodoks, ku siç dihet ortodoksia (Serbët) pas betejës së humbur nga aleanca ndërballkanike e më gjërë në Fushë – Kosovë 1389, ligji miqësi me sulltanin, pasi djali i sulltanit të vrarë në Fushë – Kosovë mori për grua Hierinën bijën e despotit të nënshtruar serb, Gjergj Brankoviç.

11. Dhe së fundi ne menduam të riprodhojmë disa rreshta nga një albanolog, studiues e historian austriak, i cili ka qenë konsull i përgjithshëm i Austrohungarisë në Shkodër (1897-1904), i cili në ato vite shkruante: “...Ndërtesa më interesante është një xhami me minare të rrëzuar e cila ndodhet në të djathtë të rrugës që të çon në oborrin e tretë. Ajo mbahet si Kishë e vjetër, për çka dëshmojnë mbetjet e një qemeri të kryqëzuar gotik i cili duket midis xhamisë dhe minares. Ndoshta kjo është kisha katedrale që i kushtohet SHËN SHTJEFNIT e cila ndodhet në Kështjellë, e që ishte shndërruar në xhami, dhe që ende në vitin 1685 ruante si trofe një organo që nuk qe prishur. Shqyrtimi në brendësi nuk lejohet pasi ndërtesa sot përdoret si depo municioni.

12. Në këto “dëshmi” të dekumentuara mund t’i gjejmë edhe tek autorë të tjerë (vendas apo të huaj) e mbi të gjitha mund t’i gjejmë tek Volumet e ILIRICUM SACRUM, por mbasi këto i pëkasim historisë së Ilirisë së Shenjtë, pra Besimit Kristian, ne menduam që të rëndisim materiale dhe dekumente të shkruara nga albanologë, shkencëtarë, studiues dhe historianë në shumicë laikë, e jo hierarkë të besimeve. Githsesi sot në Kala janë rrënojat dhe


gurmët e kishës së Shën Shtjefnit, ndonëse dikur ka qenë kthyer në xhami nga pushtuesit turq, që sipas gojdhënave, u detyruan të mos e përdorin më si xhami, pasi shpesh kanë ndodhur fatkeqësi, ndaj pushtuesit u detyruan ta kthejnë në depo municioni, ku edhe kështu thuhet se kishte shpërthime të ndodhura vetë e me pasoja për Kalanë e më gjërë. Natyrisht ne nuk kemi ndërmend të bindim njeri apo vetë shtetin për të rikonstruktuar muriet që sipas dekumentave, do të rikthenin të paktën për vlera muzeale e historiko-kulturore kishen famëmadhe të Shën Shtjefnit, që për disa shekuj ka qenë Shenjti Patron, apo më saktë mbrojtës i qytetit të Shkodrës e më gjërë, dhe “e humbi” këtë tager pas shekullit XV, kur në kala u dyn-dën si re të zeza ata pushtues që për 432 vite nuk u larguan nga këto troje, duke na lënë jo pak pasoja të cilat vazhdojnë të na kushtojnë. Ndaj Kisha e Shën Shtjefnit (e rikonstruktuar), mund të jenë një karti identiteti plus për të zënë vendin që na ta-

kon në sofrën e Europës së Bashkuar.

Ndue Bacaj

REFERENCAT:

1. Bibla, fq. 1553
2. Beslidhja e re, fq. 376
3. Areberia Venedike (1392 – 1479), Oliver Jen Schmitt, fq. 130.
4. Vende, kisha, lumej, male e toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore. Fq. 130-131. Ermanno Armao.
5. Arbëria Venedike (1392 – 1479), Oliver Jen Schmitt, fq. 100.
6. Po aty... fq. 120.
7. Po aty... fq. 129.
8. Po aty... fq. 131.
9. Po aty... fq. 147.
10. Studime Shqiptare, Dr. Johan Georg von Hahn, fq. 138.
11. Veprat e lavdishme të Skënderbeut, Dhimitër Frangu, fq. 104.
12. Shqipëria e Vjetër, Theodor Ippen, fq. 120.



të gjithë banorët e Shkodrës, si qytetarët ashtu edhe banorët e rrethinave rrokknin qënien e tyre brenda komunës nëpërmjet kremtimit të Shenjtorit të qytetit, Shën Shtjefnit “Nostro confaloner”. Ky kremtim përbënte një pikë kulmore në vitin e jetës së shkodranit. Në ato ditë të huajt gëzonin një mbrojtje të veçantë ligjore. Kur ndodhen në vitin 1346 në Kishën e Shën Shtjefnit (Stefanit) disa mrekullilajmi u përhap si vetëtimja dhe e ngriti edhe më shumë lavdinë e Shenj-

prerjen e monedhave edhe gjatë sundimit të Balshajve. Si rregull paraqitej në këto monedha Patroni i qytetit; Shën Meria në Ulqin, Shën Shtjefni (Stefani) në Shkodër.

9. Fortunat që kaluan mbi Kalanë e Rozafës apo Shkodrës më qartë, ishin të shumta, por ato që erdhën pas pushtimit Otoman në vitin 1479, kishin trajta shkatërrimtare, për qytetin dhe popullsinë e saj e cila siç thuhet mbeti vetëm me 405 burra dhe 105 gra, të cilët edhe ata ikën në Vene-



Nënë Tereza

Sa nderë kemi që je shqiptare,
Me zemër të madhe dhe shumë bujare.
Ti nëpër botë kudo ku shkove,
Me zemër të bardhë e të pastër,
Pa dallim të varfërit i ndihmove.

Të gjithë Nënë të thirrmin
Dhe ti Nënë ju dole,
Se shumë të sëmure
Me duart tuaja i shërove.

O Nënë e dashur,
O Nënë e madhe,
I shërbeve Zotit me zemër bujare,
Fjalën e Krishtit Ti e ke dëgjuar
E urdhërimet e tij i ke zbatuar.

O e Lume Nëna Terezë,
Sa bamirëse e madhe dole
Gjithë jetën tënde
Të varfërve ua kushtove.

O e Lumja Nëna Terezë
Zoti Ty të ka bekuar
Dhe me fjalën, E Lume
Ty të ka emëruar.

Loreta Dodani
Klasa e 8-të A, Shkolla “Zemra e Krishtit”

Julian Assange, Jeta deri në themelimin e "Wikileaks"

Është folur shumë për "Wikileaks" këto javë, por të pakta janë ende informacionet personale për themeluesin dhe kryeredaktorin e këtij sajti, që po ndryshon diplomacinë botërore dhe shumë koncepte që kanë të bëjnë me lirinë e shtypit. Ja cila ka qenë jeta e tij në të shkuarën

Superhakeri, i cili tanimë konsiderohet nga të gjithë si "rrjedhësi" më i madh i sekreteve ushtarake dhe diplomatike në historinë e njerëzimit, është rritur në një ishull idilik dhe të vogël të Queensland. Një ishull me vetëm 500 banorë. Ai vetë ishte një "Tom Sayer", i cili e kalonte ditën duke zënë peshk dhe zogj.

Julian Assange ka lindur në korrik të vitit 1971 në Townsville, në bregun e Queensland dhe thotë se për të ka qenë shumë i zakonshëm stili nomad i jetës dhe deri në moshën 14-vjeçare kishte ndryshuar 37 vendbanime së bashku me prindërit. Ata punonin në teatër dhe ishin shpesh në udhëtim nga një vend në tjetrin. Ai dhe gjysmëvëllai i tij nuk kanë marrë një shkollim formal. Këtë e shpjegon mamaja e tyre, Kristine, në një intervistë që ka dhënë së fundi, ku ka thënë: "Nuk doja që shpirti i tyre të thyhej". Ajo besonte se shkollimi formal do të nxiste te djemtë e saj respekt të pashëndetshëm për autoritetin dhe do të zbehte dëshirën e tyre për të mësuar. Prindërit e Assange ishin antikonformistë të regjitur. Vetë australiani 39-vjeçar ka deklaruar shpesh se ka kaluar shumë kohë nëpër librari dhe biblioteka, duke marrë në duar vazhdimisht libra të natyrave të ndryshme, të cilët i lexonte, i nënvizonte dhe i mësonte në disa raste. Për sa i përket mësimeve, ai ka marrë disa orë me korrespondencë, ka pasur mësime informale nga pedagogë universiteti dhe në disa raste kanë qenë prindërit që i merrnin mësues në shtëpi fëmijëve të tyre. Dy nga vendbanimet e familjes Assange, gjatë periudhës së udhëtimeve dhe zhvendosjeve të vazhdueshme, kanë qenë Magnetic Island, një ishull shumë i vogël i konsideruar si trashëgimi kulturore disa kilometra larg Townsville dhe Byron Bay. "Pjesa më e madhe e fëmijërisë sime ka qenë e ngjashme me atë të Tom Sayer", ka deklaruar Assange në një intervistë për gazetën "New Yorker" "Unë kisha kalin tim, ndërtoja çerdhe për zogjtë dhe

më pëlqente shumë që të peshkoja. Më pëlqente shumë edhe të eksploroja vende të reja, të futesha në thellësitë e minierave të braktisura...".

Ai flet gjithmonë me ngrohtësi për fëmijërinë e tij në brigjet australiane. I tillë është edhe një artikull-opinion në një gazetë australiane, në të cilën Queensland cilësohet si një nga vendet që e

edhe sajtin e tij "Wikileaks", motoja e të cilit është: "Ne i hapim qeveritë". "Jam rritur në një zonë të Queensland-it, ku njerëzit flasin shumë hapur me njëri-tjetrin dhe i thonë gjërat troç. Janë njerëz që nuk u besojnë qeverive, duke e konsideruar qeverinë diçka lehtësisht të korruptueshme, që duhet mbajtur nën vëzhgim vazhdimisht. Ditët

dëshmi e asaj që mund të ndodhë kur politikanët e pengojnë median që të thotë të vërtetën", ka shkruar Assange disa orë para se të arrestohej.

"Të gjitha këto kujtime dhe impresione kanë qëndruar me mua. 'Wikileaks' u krijua duke pasur parasysh këto vlera bazë. Ideja u konceptua në Australi dhe në mbështetje të saj u ven-

Në shtator të vitit 2009, zonja Assange shkroi rreth kohës së qëndrimit në Magnetic Island, në një ditar të saj.

"Emri im është Assange. Kam jetuar në këtë ishull tre herë. Për herë të parë, në vitin 1971, si mama beqare, me djalin tim të vogël, Julian. Kisha marrë me qira një shtëpizë të vogël për 12 dollarë në javë në



bënë që të reflektonte për të vërtetën dhe transparencën dhe ku i lindi ideja e parë për të krijuar

e errëta të korrupsionit në qeverinë e Queensland-it para nisjes së hetimit të Fitzgerald janë

dos që të përdorehin teknologji të reja, në një mënyrë për të mbështetur të vërtetën".

Picnic Bay. Jetoja gjatë gjithë kohës me rroba banoje, si banorët e ishullit që ishin me

veshje shumë të lehta dhe gjatë gjithë kohës qëndroja me femijën tim dhe me mama të tjera të ishullit. Në vitin 1976 u ktheva sërish me bashkëshortin e dytë. Jetova në Horseshoe Bay, në një fermë të braktisur, kurse herën e tretë kam ardhur sërish në këtë vend në vitin 1982 dhe këtë herë, përveç djalit të parë, kisha me vete edhe djalin tim të dytë. Më pas jam kthyer edhe si gjyshe, me të dashurin tim dhe jam shumë e dashuruar me ishullin, edhe pse më është dashur që të qëndroj gjithmonë për një kohë shumë të shkurtër”.

Sipas disa të dhënave në vitin 1970, ishulli ka pasur vetëm 500 banorë, ndërkohë që tani ka më shumë se 2000. Për rritjen e një femije është ndoshta vendi më i bukur dhe më i mirë që mund të imagjinohet, sepse njerëzit janë shumë të hapur, të çiltër dhe kanë gëzim për jetën. Nuk bëhet fjalë për krime dhe femijët janë të lirë që të shkojnë ku të duan dhe të kalojnë një femijëri zbavitëse. Prindërit mund të jenë të qetë, pa paranojat që kanë në

vende të tjera të botës për sigurinë e femijëve. Kur Assange ishte 8 vjeç, prindërit e tij u divorcuan dhe e ëma nisi lidhjen me një muzikant, i cili më pas filloi që të abuzonte me të. Ajo e braktisi muzikantin, por u detyrua që ta merrte përsëri nga frika se mos i hiqnin nga kujdesi femijën e dytë, që e solli në jetë me të.

E kështu familja shkante nga një vend në tjetrin, në varësi të punëve të prindërve. Zonja Assange i bleu të birit, në moshën 13-vjeçare, kompjuterin e parë për 600 dollarë. Ajo kujton më pas se Julian ishte një djalë shumë i zgjuar dhe i shkathët dhe kishte nevojë që të thellonte dijet, për më tepër në një vend që nuk kishte shumë gjëra për t'i ofruar. Po sipas rrëfimeve të mamasë së Julian, djaloshi tani e kalonte gjithë kohën me kompjuterin e tij të ri, me të cilin nuk ndahej as kur flinte. Për Julian kjo ishte dhurata më e bukur që mund t'i bënin, sepse e kishte pasur pasion që në femijëri. Me kalimin e kohës, Assange u zhvendos në Melburn, së bashku me familjen

dhe që në atë kohë, kishte filluar që të njihej si një njeri shumë i zoti me kompjuterët kryesisht për sa i përket programimit. Ishte kjo edhe periudha kur ra në dashuri me një vajzë 16-vjeçare, ndërsa ai ishte vetëm 19 vjeç. Po atë vit u martuan dhe sollën në jetë një djalë me emrin Daniel, që sot është 20 vjeç.

Eksperimentet e Assange me kompjuterët tërhoqën shumë shpejt vëmendjen e policisë. Në vitin 1991 ai u kap nga autoritetet pasi së bashku me disa shokë kishte arritur që të futej në terminalin kryesor të kompanisë kanadeze të telekomunikimeve dhe u dënua me 31 akuza për hyrje të paligjshme në rrjet. Në të njëjtën kohë e shoqja e la, duke marrë me vete djalin e vogël. Assange nisi kështu një betejë të gjatë për të marrë të birin, Danielin ndërkohë që priste edhe vijueshmërinë e procesit gjyqësor në lidhje me akuzat që i bëheshin. Kur procesi përfundoi në vitin 1995, ai u cilësua fajtor për 25 akuza dhe arriti që të shmangte burgun me kusht që

të mos e përsëriste më të njëjtin gabim.

Në atë kohë gjykatësi tha: “Nuk ka asnjë lloj prove në favor të akuzave për një ndërhyrje të qëllimshme në rrjetin e kompanisë. Kjo të çon në përfundimin se ka qenë thjesht një kënaqësi profesionale për Assange dhe shokëve të tij dhe si pasojë ai lirohet me kusht që të mos e përsërisë këtë ‘krim’”.

Por ajo që e bëri me të vërtetë Julian që të thindej i tëri ishte beteja legale për marrjen e të birit. Nga një djalosh me flokë kafe, ai u shndërrua në një djalë me flokë të bardha borë, siç e kemi parë shpesh kohët e fundit para se t'ua ndryshonte ngjyrën për shkak të fshehjes. Të paktën këtë e ka thënë vetë Assange për një gazetë para disa kohësh. Në vitin 1999, Julian arriti që të merrte leje për të parë dhe për të qenë me të birin, por kjo i kushtoi shumë shqetësime atij dhe së ëmës. “Mendoj se pasi gjithçka mori fund, përfundova me çrregullime stresi post-traumatike, sepse ishte si të dilje nga një luftë. Ti

nuk mund të komunikosh me njerëzit e tjerë në një mënyrë normale dhe këtë problem e kam pasur për shumë kohë”, deklaroi Assange.

Më pas ai ka udhëtuar shumë në Azi, ku ka punuar në një sërë fushash të ndryshme, përfshi konsulentin e sigurisë, në gazetari dhe më pas ndërtoi edhe një kompani IT të tijën. Ndërkohë përpiquej që të bënte para për të mbështetur financiarisht të birin. Në moshën 20-vjeçare shkoi në Melburn për të studiuar matematikë dhe fizikë. “Wikileaks” e themeloi në vitin 2006, që në fakt ishte një sajt në të cilin ai u ofronte mundësi të gjithë njerëzve që të hidhnin materiale komprometuese.

Në një tjetër intervistë, ai ka deklaruar se ka bërë një jetë të gjerë intelektuale dhe se është i zoti në shumë gjëra e se shpreson që të realizojë të gjitha planet që ka. Për momentin ajo që Assange duhet të urojë të ndodhë, si parakusht për të vënë në jetë plan.

Wikileaks dhe Dick Marty

Në Shqipëri është folur më pak se kudo për WikiLeaks, por është folur e debatuar megjithatë mbi kundërthëniet e aktit të Assange. Të tjera dokumente që pritet të dalin edhe mbi Shqipërinë ndoshta do ta rindezin debatin, por ky tashmë është eklipsuar nga raporti i Dick Marty-t me akuzat mbi krimet e UÇK-së, me në krye Hashim Thaçin, në mbarim të luftës në Kosovë, si dhe mbi kapjen e shtetit nga krimi i organizuar atje, ashtu sikurse edhe për mosbashkëpunimin e qeverisë shqiptare për hetimin e akuzave ndaj Thaçit e njerëzve të tij. Të dy ngjarjet duken si krejt pa lidhje me njëra-tjetrën, por kanë disa pika interesante kontakti, sipas meje. Së pari, pasi të dyja kanë të bëjnë me informacione që i jepen publikut mbi atë se çka bëjnë të pushtetshmit, ndonëse debati mbi Assange është më i komplikuar, do të thojë, pasi veprimi i tij nuk vjen nga institucione në pushtet që japin informacion mbi pushtete të tjera, si raporti i Dick Marty-t. Së dyti, kanë lidhje me njëri-tjetrin, sipas meje, sepse ato që ka zbuluar Assange, në një farë kuptimi na tregojnë se çfarë ndodh në prapaskenë derisa gjërat dalin në skenë, siç doli Marty, por edhe pse nganjëherë ato nuk dalin asfajë në skenë.

Personalisht bëj pjesë ndër ata që, ndonëse njohin faqet e rrezikshme të aktit të Assange,

e konsiderojnë pozitive punën e WikiLeaks, pasi e shoh si një akt që e ndihmon demokracinë, duke u dhënë më shumë pushtet njerëzve në kontrollimin e përfaqësuesve të vet. Tek e fundit, demokraci do të thotë pushtet i popullit dhe, nëse pranojmë se një instrument i rëndësishëm i pushtetit është zotërimi i së vërtetës, atëherë në sa më shumë mendje të jetë e vërteta, aq më shumë demokraci kemi; kurse në sa më pak mendje të jetë kjo, aq më pak demokraci kemi. Thënë kjo, duhet shtuar se, sigurisht, ashtu sikurse ndodh me demokracinë në përgjithësi, kjo situatë nënkupton edhe më shumë kompleksitet, prandaj dhe më shumë vështirësi menaxhimi - shpesh ky menaxhim krahasohet me atë si të bësh muzikë me një orkestër dhe jo me një instrument të vetëm. Dikush do të thotë se një shtet si SHBA-ja nuk mund të konsiderohet si një shtet që vepron kundër interesave të popullit të vet, prandaj s'ka pse të zbulohen gjëra që ai shtet, për të mirë të popullit të vet, i gjykon se duhet të jenë sekrete. Ashtu është, por edhe s'është. Së pari, pasi duket ende e largët, në mos e paarrtshme, dita kur shtetet do të realizojnë atë idealin kur të konsiderohen se gëzojnë besim të plotë për të mos u kontrolluar nga qytetarët e tyre. Ndoshta ai lloj shteti do t'i përkiste një tjetër lloj sistemi nga ky që sot e quajmë demokraci, e cila është

e bazuar mbi qasjen antropologjike që e konsideron njeriun si të papërsosur, madje me prirje për të abuzuar me pushtetin, prandaj dhe duhet kontrolluar. Së dyti, pasi botimi i këtyre dokumenteve edhe pse mund të jetë kundër interesave të shtetit e popullit amerikan, mund të jetë në favor të interesave të popujve të tjerë, pasi dihet përsëri se nuk e kemi arritur ditën kur të gjithë shtetet të punojnë në harmoni me njëri-tjetrin për të mirën e të gjithë popujve të tyre. Ka pasur jo pak raste kur interesat e shtetit amerikan, që mund të kenë qenë (por edhe mund të mos kenë qenë) edhe të popullit amerikan, mund të jenë përputhur me interesat e pushtetarëve të vendeve të tjera, por jo me interesat e popujve të këtyre vendeve.

Këto konsiderata të përgjithshme mbi WikiLeaks i kam shprehur edhe më parë me median elektronike dhe nuk do të isha ulur të shkruaja sikur rasti të mos më sillte të lexoja një faqe të tërë të “Le Monde” me titull “Diktatura dhe Mafia e Azisë Qendrore” (14 dhjetor 2010), që u referohej materialeve të nxjerra nga WikiLeaks, i cili më tërhoqi vëmendjen në mënyrë të veçantë e më bindi edhe më fort për dobishmërinë e kurajos së Assange. Dhe nuk është se e nxora këtë përfundim pa lidhje me realitetin shqiptar. Përkundrazi, pikërisht në lidhje me të, madje dalja e raportit të Marty-t në të njëjtën kohë sikur ma ilustroi atë që po mendoja. Le të shpjegoj me pak rreshta se çfarë shkruante “Le Monde” bazuar mbi dokumentet e WikiLeaks: Fil-

lonte me materiale të Ambasadës Amerikane në Baku të Azerbajxhanit. “Interlokutor qendror dhe prioritar për SHBA-në” e cilëson ambasadori në një dokument të vitit 2008 këtë vend; “aleat në luftën kundër terrorizmit”, “partner vendosmërisht laik dhe pro amerikan në një zonë të kërcënuar nga islami radikal”. Por, vini re, nga ana tjetër, ai raporton edhe për mungesë të demokracisë dhe korrupsion e abuzime të mëdha të pushtetit në Azerbajxhan. Në një telegram të vitit 2009, ambasadori flet për presidentin Ilham Aliev, duke e quajtur Majkëll Korleone (padrinoja i famshëm i filmit me famë) për të cilin thotë se me të huajt paraqitet si një kozmopolit, kurse brenda vendit po bëhet gjithnjë e më autoritar. Në dokumentet për Uzbekistanin, protagonist na del e bija e Presidentit të vendit, Karimova: “një person i etur për para e për pushtet, që përdor të atin për të shkatërruar biznesmenët e tjerë që i dalin në rrugë.” Lidhur me Kazakistanin, ambasadori amerikan atje raporton një bisedë që ka bërë gjatë një darke kokë më kokë me një drejtues të lartë kazak, i cili i ka thënë: “Kapitalizmi - siç e quani ju ekonominë e tregut - do të thotë shumë para. Dëgjoni mua, të gjithë ata që kemi lart janë të marrë fund. Janë të marrë fund për shkak të mentalitetit sovjetik që kanë; janë të marrë fund edhe për shkak të teprimeve korruptive të kapitalizmit. E dini ç'thonë? Përderisa edhe ata të Goldman Sachs fitojnë 50 milionë dollarë në vit dhe udhëheqin pastaj ekonominë amerikane, ç'ndryshim ka me këtë që bëjmë

ne këtu?” Kurse lidhur me Kirgistanin, “Le Monde” shkruan se atje ka një bazë amerikane në të cilën rifreskohen trupat e Afganistanit. Aty ka pasur trazira të mëdha kohët e fundit, që kanë sjellë edhe vdekjen e shumë personave, për të cilat është akuzuar edhe i biri i presidentit Bakiev, një njeri i fuqishëm në vend. Ambasadorja amerikane ha një drekë të përzemërt me këtë njeri, gjatë së cilës ky i flet për makinacionet e rusëve - sipas lojës që ka bërë edhe i ati për të përfituar nga të dy palët. Por ambasadorja nuk e ha sapunin për djathë: “Malinj i shkollluar mirë” e quan këtë personazh në raportin që dërgon, por ndërkaq shkruan: “Nëse marrëdhënia me këtë njeri do të trajtohet me kujdesin e duhur, ne mendojmë se mund të nxjerrim përfitime prej saj” - paçka se në analizat që i dërgohen Departamentit të Shtetit shkruhet edhe se “korrupsioni i gjithëpërhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes është pengesë për zhvillimin ekonomik.”

Mua më duket se mjafton një “NO COMMENT” për t'i mbyllur këto radhë. Besoj se nuk ka shqiptar në Shqipëri e në Kosovë - nuk e kam fjalë për ata që janë në pushtet, por për shumicën që vuan prej pushtetit - që, duke lexuar këto që shkruan “Le Monde”, mbështetur mbi dokumentet e WikiLeaks, të mos nxjerrë përfundime të mençura për vendin e vet dhe të mos falënderojë për këtë edhe guximin e Assange.

FATOS LUBONJA

Në Kelmend, ku e vërteta ngjan si legjendë

Sheh monumentin e heroit kombëtar Prekë Cali në Shkodër dhe në kujtesë të troket një pjesë histori. Të troket ajo histori shqiptare brilante që për dekada të tëra komunistët na e servirën si antishqiptarizëm.


Le të nderojmë pak çaste Kelmendin, truallin që lindi e rriti antikomunistin, viganin, apostullin e pashoq të shqiptarizmit.

Pra, Kelmendi, zona më verilindore e Shqipërisë, ky truall i Eposit të Kreshnikëve përkundi në fillim djepët e legjendave të Mujit e Halilit. Në majmalet e tij e kishin strehëzën zanat e malit e shtozovallet. Mespërmas krahnës, në të dy anët, nga zona e Vuklit dhe ajo e Selcës, e përshkojnë dy lumenj, dy Ceme vrapkulçedër e syringjelbër që bashkohen në Tamarë, duke u dhënë brigjeve një hijeshi si rrallëkund. Treva veriore u shemb e u shkumbua tre herë me rropamë, e po me aq madhështi u ngrit si një Sfinks gjigand. Aty hollit shtat Nora, ajo vajzë me butësi trëndafil e zemër luaneshe, vajza e luftëtarit selcjan Vuk Marash Uci, ajo sokoleshë që hyri me dinjitet në analet e historisë sonë, ajo Orë Mali që i preu kryet Pashait osman, Vuçi Pashës mu në qendrën e tij ushtarake, në Zall të Bruzit, në hyrje të fshatit Selcë, në prezencë të plot 30.000 nizamëve. Aty lindi e shkroi histori Nikë Leka, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, aty lindën e u rritën atdhetarë që ngritën flamurin e parë në historinë shqiptare. Është fjala për qëndresën antiturke të vitit 1911, ku Oso Kuka e Prekë Cali, duke favorizuar ndërkombehtarisht me anë të një peticioni kryeneç dhe logjik çështjen shqiptare pranë qeverisë britanike, ngritën flamurin në Deçiç dhe mbajtën kuvendin e krerëve shqiptarë në Gerçë dhe miratuan "Librin e kuq" me 12 kërkesa drejtuar qeverisë Osmane që paraprinë dhe përgatitën terrenin për ngritjen e flamurit në Vlorë, më 28 Nëntor 1912 nga Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi, ashtu sikundër thotë edhe kënga: "Përmbi Selcë vargojnë do male / Thikë përjetë si mur kalaje / Bash njeri kuvendi mlodhi / Ma të mirët e ktiç trolli / Përreth ahut shekullor / Zbardhin tirqet bardh si bora / Dëgjojnë malet, ndalin gurrat / Gju më gju kuvendojnë burrat / Le ta dijë Perandoria / Ma nën zap s'duron Shqipëria".

Në Kelmendin e Prekë Calit, në atë truall që ndjen nder të jesh bir i tij, u lind e u rrit edhe Françeskë Albanesi, skulptor e erudit i Rilindjes Italiane. Ky mjeshtër i gdhendjes u bë i pavdekshëm me Altarin e Kryekishës së Milanos që nuk është thjesht një monument kulturi, por një ndër monumentet më në zë të kulturës botërore. Aty rriti shtatin e vet edhe famozi Angjelin Prelocaj, miku më i ngushtë dhe më i vlerësuar i Ismail Kadaresë, njëshi i baletit në botë, i cili iku fëmijë nga diktatura komuniste dhe sot jeton në Paris. Historia e tij është e njëjtë me atë të Gjekë Marinës, që po trondit globin me vjershat e tij. Aty, në Kelmendin e Prekë Calit, At Gjergj Fishta nisi vargjet e para të "Lahutës së Malëcisë". Diku në luginat e Kelmendit heroik, pikërisht në Nikçin e të parëve të Ibrahim Rugovës e Rexhep Qoses, armëtarët e hershëm shpikën e

prodhuan topin prej dardhe me barut autokton.

Por njëri nga kulmet, mbase më i larti, me të cilin mburret ky vend i lashtë sa krijimi i ujit e ajrit, Qielit e Tokës, është fakti se lindi, rriti, burrëroi heroin tonë kombëtar Prekë Calin, i cili siç do dëshmojnë rreshtat e këtij reportazhi me fakte të gjalla, të cilat diktatura komuniste e kaluar dhe e tashme, megjithëse i syrgjyño-



si, s'mundi jo vetëm t'i fshijë, por as t'i eklipsojë, do të shndërrohej në një përbindësh për cilindo që tentoi të skllavëronte, nëpërkëmbte apo ndërmerre ndonjë masakër kundër vendlindjes së tij të shtrenjtë e bashkë me të, mbarë truallit shqiptar.

SHQIPËRIA PA VERMOSHIN, NJË TRUP PA KRYE

Figura të tilla si Prekë Cali, edhe shtete i Franca, Italia, Amerika do i kishin nder.

Zbërthimi i një figure të tillë madhore si Prekë Cali, natyrisht kërkon një kujdes të veçantë, por ne mund të themi pa droje që ai kishte një intuitë dhe atdhetarizëm që rrallë i gjen shoqe. Nuk ka si të nderohet ky martir i Shqipërisë nga socialkomunistët, ashtu sikundër nuk kishte se si t'i besonte megalomanisë së komunistëve, pasi në platformën e këtyre djajve të kuq gjithëherë është shtuar këmbëkryq rreziku pro sllav për kombin. Ky burrë i mençur e trim si zana, ka mbajtur në gjoksin prej viganin dokumentin me vulat e shtatë Krajlive të Europës, çka është në rast unik në tërë historinë tonë. Si përfaqësues i palës shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, ai punoi me diplomaci në shërbim të çështjes shqiptare. Prekë Cali nuk u tremb syri as në qelitë e errëta ku e përplasi regjimi i Ahmet

Zogut, pasi ai ishte një mbështetës i fuqishëm i lëvizjes së qershorit 1924, krahu Fan Nolit. Ahmet Zogu tregoi një politikë të butë me kundërshtarët. Pra vetëm katër vjet qëndroi në burgun e Gjirokastrës. Gjatë asaj kohe Prekë Cali bëri "mik" edhe një fëmijë, Enver Hoxhën, të cilin edhe e shpëtoi, e nxori para kohe nga qelia me ndërhyrjen e tij direkte tek Ahmet Zogu, pasi mendonte ta kishte më vonë në krahu të tij. Por

përshatje të vogël, për të cilën miku ynë Mernaçaj jemi të bindur se na kupton, shkëputim: "Fjala nuk zgjat, u nis kuvendi / Këtu tha Prenka, nuk asht vendi / Me ngul gur, me vu kufi / Ky asht dheu i t'parëve të mij / E, rrehet keqas kush mendon / Se këto male i kapton / T'an malësia asht betua / Deri sa krejt të jem farua / Një pëlëmbë tokë t'huejt mos m'ja lëshua / Një angleze, grua fisnike / Kur dëgjon ato fjalë kreshnike / Pak përmallshëm Prenken e ka dvetë / Pse ti Cali kaq me t'nxehtë? / Pse i del zot këtij vendi të shkretë? / -Moj sojnikë t'u ngjattë jeta / Për Shqipni janë male t'vlefa / Janë pyje, me kullota / E kund ma t'bukura s'i ka Bota / Brez mbas brezi, unë e di / Ktu kanë këndua t'parët e mij / Gjithmonë t'huejt na kanë ngatrrue / Deri n'vorre na kanë cermue... / Komisioni ra n'mendime / Hajt pra, Beg, po t'lam me pri / Njaty Preka vu kufi".

Proverbial për të gjithë brezat ka ngelur postulati i tij në një konferencë diplomatike në Londër rreth çështjes së kufijve: "Shqipëria e vogël ka burra të mëdhenj. Ajo pa Malësinë e Shkodrës do të ishte një trup pa krye..."

Nazistët gjermanë në vitet e pushimit fashist, i ofruan grada e poste të larta Prekë Calit, me kusht që ky që syrgjynosej larg trojeve të veta. Këtë ofertë nuk kish se si ta pranonte viganin i maleve shqiptare. Ai qëndroi në viset e veta, i mbështeti këmbët fort në tokë, si Anteu, grumbulloi rreth vetes shokë të idealit kombëtar si Prelë Tomën (Smajlaj), Dedë Gjonin, Ndue Gjo-rapakën, Gjekë Selcën, Gjergj Lulën, Nikollë Preçin, Dedë Lulash Smajlin, Gjokotë Ujkën, Maç Lucën, Fran Doshin, Fran Pretash Zogun e shumë atdhetarë të tjerë.

Në janar të vitit të parë të pasçlirim-it, prijësi i maleve organizoi në fshatin Brojë një kuvend të krerëve të zonës për të koordinuar veprimet kundër uzurpimit komunist, i cili identifikohet me synimet gllabëruese të serbo-malazezëve.

Prekë Cali, trim sa vetë trimëria, i meçur sa vetë mençuria, i matur sa vetë maturia, i urtë sa vetë urtësia, mban lidhje tepër të ngushta me personalitetet britanike, pasi me ndihmën e tyre synonte të realizojë ëndrrën e tij të kahmot: "T'i kthejë sytë nga Perëndimi", pasi sipas filozofisë së tij, vetëm atje gjendej burimi i qytetërimit dhe i të mirave materiale. Meritë e Prekë Calit ishte dhe krijimi i relatave aq të ngushta me prijësit të tillë si Abaz Kupin, Jup Kazazin e burra të tjerë të shquar të kombit shqiptar.

KOMUNISTËT, TË ETUR PËR GJAK

Pas përpjekjeve të dështuara të Prekë Calit për një marrëveshje me udhëheqësit e forcave partizane, pasi tashmë me Enver Hoxhën ishin të deklaruar kundërshtarë deri në vdekje, a përtej saj, zbret muzgu i 10 janarit 1945; Brigada e Parë me komisar Fejzi Micolin, i turret Kelmendit. Fshati Brojë zihet në befasi, në gjumë. Mark Gjeloshi i Rahovicës lëshon kushtrimin në Vukël e Nikç. Thirrja kumbon në çdo kullë malësore dhe tek Ura e Tamarës, aty ku katërqind vjet më parë ishin mbytur me gurë tre taborre osmane, në

mëngjesin e herët të 11 janarit gjithë burrat, madje edhe gratë, u bënë grusht për të mbrojtur tokë e nder. Këtu, përsëri prijësi Prekë Cali kërkon ballafaqim me partizanët komunistë për t'i mbyllur plagët e gjakderdhjes e për të çuar një komision tek Enver Hoxha për të nënshkruar një udhë logjike për të ardhmen e Shqipërisë. Por loqun e bisedës për mirëkuptim, dialog, paqe, ardhmëri, e turpëron breshëria e plumbave të pabesë. Vetë komisar i kuq i drejton tytën e për kah gjokset e malësorëve. Në çast, si vetëtimja që çan qiellin, gjokset ngjeshen e bëhen shkëmb, e plumbave u përgjigjen me plumba. Bora skuqet nga të shtënat e para të tyre. Trupi pa jetë i komisar Micolit varet si leckë e qullur në yzengjitë e mushkës që hingëllin. Akulli përreth nis e shkrihet nga gjaku i pafajshëm shqiptar. Ç'tragjedi mesjetare e kohëve të reja?! Tërë ditën vazhdon shkëmbimi i zjarrit. Në mbrëmje vonë komunistët tërhiqen me panik e gjynahe për viktimat pa faj të një ideje, që siç do vërtetohej më vonë, izoloi e paralizoi Shqipërinë. Megjithë humbjet e mëdha në të dy polet, por sidomos të uzurpuesve, si dhe të 25 robërve komunistë në duart e Prekë Calit, Prijësi Legjendar i Maleve, i cili edhe në Shkodër kish lënë histori duke çelur shkolla e objekte kulturi, kisha e xhamia, nuk ngurron të thërrasë sërish: "T'i mbyllim plagët e gjakderdhjes, të hartojmë një plan të mesëm se jemi shqiptarë...". Por komunistët ishin të palatuar. Donin veç gjak e katrahurë.

Gjithsesi, është në nderin e burrërinë e malësorëve që 52 robërit e zënë, pa mjekimit me kujdes të plagëve e trajtimit shumë të mirë e njerëzor, i përcollën e çuan deri në familjet e tyre.

Ka patur nga ata robër që kanë vajtur deri tek Enver Hoxha dhe kanë treguar mençurinë e burrërinë e Prekë Calit. Komandanti komunist, pasi i ka dëgjuar, i ka pushkatuar!

TJETËR PABESI E TERROR

Pesë ditë pas kasaphanës së parë, ethet e çmendura të hakmarrjes, i ndërsejnë krerët e brigadës së parë. Marrshimi drejt viseve të Shqipërisë Veriore, ndërmerr një inkursion me përmasa tepër të mëdha.

- O kriminelë pa fe e Atdhe, këtu më keni, tek Gryka e Shtegut të Kaut, - shpërthen një oshëtim që rrok kupolat e maleve. Ky zë gurgullon nga zemra e Prekë Calit e trimave të tij në pritë, të gatshëm për të dhënë jetën për vatan e ide.

Lufta plasi. Qëndresa e bijve të Malësisë që nuk duan gjakderdhje, është heroike, e pashembullt. Për tre ditë e tre netë pa ndërprerje duhma e rëndë e barutit infektoi ajrin e pastër të Bjeshkëve. Malësorët nuk e njohin "artin" e rënies në gjunjë para askujt, sado kabil e i armatosur të jetë. Të 79 vitet mbi kurriazin e azganit Prekë Cali reduktohen në gjysmën e tyre. Përvoja jetësore e ka brumosur t'i urrejë në kulm e themel pushtuesit e çdo ngjyre qofshi. Strategjia e taktika e Prijësit Legjendar nuk maten me kutin e asnjë gjeneralit tjetër.

Nëpër luginat e Kelmendit, në ato tre ditë katrahure, pellgjet ujore të Cemit patën në brendësinë e tyre grumbuj

Kur lufta brenda llojit quhet disidencë

Nga Ardian NDRECA



A kanë ndryshue shpirtnisht disidentat e Bllokut në vitet e burgimit apo të internimit?

Ka gjasë që burgu dhe internimi t'i ketë ndërgjegjsue

ndaj njeni-tjetrit dhe ndaj gjithë frymorëve në përgjithësi. Nji pjesë e tyre kishte mbarue ndonji gjimnaz në kohë të monarkisë e fill mbas luftës kishte krye kurse dhe shkolla në Jugosllavi dhe në BRSS. Kurse pjesa ma e madhe ishin gjysmë-analfabetë dhe gjysmë-njerëz të ardhun prej krahinave ma të humbuna, ku qytetnimit nuk kishte kalue as aq sa nevojitet për me më-sue gjanat ma thelbësore – këta të fundit kishin shumë ma tepër arsye me ruejt postet e fitueme me gjak.

Padyshim që e drejta me jetue në Bllok ishte fitue me gjak; Ma së shumti me gjak shqip-

ishin e vetmja gja që funksiononte si meçik në Shqipninë e Enver Hoxhës qysh prej vitit 1945 e këta, vetëm në vitet '60 apo në vitet '70 e mësuen këtë gja! Edukimi komunist ishte nji gja e neveritshme, por riedukimi ishte nji mjerim i vërtetë.

E pra zona mes edukimit dhe riedukimit përcaktohej prej humorit të nji funksionari me xhakët gjithmonë demodé apo prej nji operativi që kishte vetëdijen e nji qeseri, prej nji kryetari Fronti apo prej nji spiuni të padukshëm që firmoste nji letër dhe shkatronte nji jetë. N'ato vite marria ishte ba kujdestarja e arsyes, tue e ndryshue kështu cilsinë e vetë

terrorizuen shqiptarët – patën mundësinë me përfundue me ceremoni në burgjet komuniste. Këto ishin rastet kur ato burgje kryenin me të vërtetë funksionin e tyre natural.

Megjithatë, ata në burgje nuk përfundonin pse urrenin komunizmin apo pse ishin mërzi të me mësimit e Marksit apo të Leninin, përkundër, shumica e tyre e deshtën Marksit dhe Enverin deri në fund. Asnji prej tyre nuk përfundoi në burgje pse vërejtji tek komunizmi nji sistem shtazor që vorfnoi vendin dhe shkatërroi shqiptarin, por thjesht pse mbrenda llojit shpërthente tash e parë nji ritual spastrues primitiv. Për me e ruejt të shëndetshme Partinë nga kolera herë mbas here digjeshin disa dordoleca. Por edhe ata që digjeshin për me afirmue higjienën e Partisë nuk ishin as shenjtën e as filantropë të shqiptarëve. Ndonji sish, që ushqente trille (velléités) letrare, deshti me ia lanë «fajin» e burgimit letërsisë që kishte shkruet. Por po të lexohet sot ajo palo letërsi të çohen flokët përpjetë prej idiotsinave të skematizuese me talent aparatçikut. Po të kishin përfundue me të vërtetë në burg për arsye të letërsisë së tyre, nuk do t'i kishte dënue Enver Hoxha por Klioja, Melpomeni, Eratoja apo ndonji muzë tjetër.

Disidentat e Bllokut kanë besue tek Partia derisa u ka leverdisë, kanë rrahë shuplakë derisa u janë çue duert gjak, dhe s'kanë ndejt asnjherë pa ngritë dorën për me çue drejt pushkatimit apo drejt internimit njerëz të pafajshëm. Kjo asht arsyeja pse sot mbeturinat e shkaktarëve të nji makthi shumëdekadash nuk janë të besueshëm për shoqinë civile as kur flasin për të kaluemen dhe as kur mendojnë për të ardhmen. Intervali mes Shqipnisë së vërtetë dhe monstrës që ata drejtpërdrejt apo zhdrejtazi krijuen nuk mund të mbushet me banalitetet e bezdisshme që tregojnë sot.

A kanë ndryshue shpirtnisht disidentat e Bllokut në vitet e burgimit apo të internimit?

Zemra e njeriut nuk mund të shqyrtohet lehtë, por ka gjasë

që burgju dhe internimi t'i ketë ndërgjegjsue rreth idesë çnjerëzore që u dha pushtet, rreth tmerrit që ata dhe familjet e tyre i shkaktuen shumicës së shqiptarëve, rreth padrejtësisë së privilegjeve që gëzuen për vite me radhë... Ndoshta ky ndërgjegjsim ka ndodhë, mbasi nuk duem me besue se sot gjithë mllefi i tyre asht vetëm pse nuk mujtën me e çue deri në fund rrugën me privilegje ku rastësia historike (dhe jo intelijenca, talenti apo meritat) i kishte katapultue.

Për me e kuptue se populli shqiptar asht popull i mirë, nuk mjafton vetëm me shkue e me rrëmue dokumentat e vërteta ku tregohet se nji pjesë e kuislingëve shqiptarë dhe nji pjesë e njerzve të thjeshtë shpëtuen hebrejnt. Mjafton me pa sesi mbas ramjes së komunizmit gati asnji prej atyne që nga Jugu në Veri vuejtën padrejtësisht dhe qenë viktima të terrorit komunist për dekada, nuk shkuen me ua shkrepë në lule të ballit shokut Ramiz, shokut Aranit, shokut Hekuran, shoqes Nexhmije... që e meritonin plotësisht nji gja të tillë. Ky asht jo vetëm ndryshimi mes qytetnimit dhe barbarisë por dhe treguesi se hakmarrja politike ishte tipar i ideologjisë komuniste, e ky tipar themelor i saj i krijoi nji disidencë të rreme en bloc – krijoi gogsimat e nji darke makabre ku të ftuemit e nderit përfunduen tue hangër njeni-tjetrin.

Si mund të trajtohet si shfaqje disidencë fakti që ndonji prej tyre jetonte si viveur në nji kohë që populli rrinte në radhë? Çfarë disidencë asht me mbajtë flokët e gjatë në nji vend ku rrena i kishte kambët ma të shkurta se kurrkund tjetër në botë? Për me e kuptue se populli shqiptar asht popull i mirë, nuk mjafton vetëm me shkue e me rrëmue dokumentat e vërteta ku tregohet se nji pjesë e kuislingëve shqiptarë dhe nji pjesë e njerzve të thjeshtë shpëtuen hebrejntë Mbas ramjes së komunizmit gati asnji prej atyne që vuejtën padrejtësisht nuk shkuen me ua shkrepë në lule të ballit shokut Ramiz, shokut Aranit, shokut Hekuran, shoqes Nexhmije... që e meritonin plotësisht nji gja të tillë.



rreth idesë çnjerëzore që u dha pushtet, rreth tmerrit që ata dhe familjet e tyre i shkaktuen shumicës së shqiptarëve. Mund të quhej ndryshe edhe "disidencë brenda Bllokut", por Blloku mbetë gjithsesi nji metaforë e lidhun gjeografikisht me nji copë territori të kufizuem ku jetonin disa borgjezë shpirtvegjël të farkëtuem në momentet e çlodhjes prej "luftës së egër të kllasave".

Privilegjet, karriera, lufta për ekzistencë, rreziku që nji ditë mund ta pësonin – bante që ishkomisarë e komandanta partizanë, agjitorë dhe agjitore, njerëz të randomtë për nji shoqni normale - të ktheheshin në uj

tarësh. Por blloku nuk mbaronte mbrenda Bllokut. Ai ishte kudo ku kishte shqiptarë që prej adhurimit primitiv apo prej tmerrit (që asht nji ndjenjë ma njerzore) – i mbanin sytë kah Enver Hoxha dhe klika e tij e çmendun dhe gjakatare.

Blloku ishte kompaktësimi ideal i njerzve pa dyshime serioze. E megjithatë nji pjesë e tyre përfundoi në kampet e përqendrimit dhe në burgjet që ata vetë patën ndërtue me zell klasor. Vetëm atëherë diktatura e proletariatit iu duk diçka skandaloze - dëshmuen ata ma vonë - dhe burgjet shqiptare iu duken çnjerëzore. Çudi, burgjet dhe diktatura e proletariatit

jetës dhe tue ba që në pesë dekada bijtë e saj të shumoheshin në progresion gjeometrik. Nji progresion i këtitillë i shtynte me ia hangër kryet njeni-tjetrit, mbasi Natyra në squetsinë e vet lejon të keqen me qëllim që e keqja të hajë vetveten.

Si mund të trajtohet si shfaqje disidencë fakti që ndonji prej tyre jetonte si viveur në nji kohë që populli i thjeshtë rrinte në radhë qysh në ora 5 të mëngjesit për me marrë 2 litra qumësht? Çfarë disidencë asht me mbajtë flokët e gjatë në nji vend ku rrena i kishte kambët ma të shkurta se kurrkund tjetër në botë? Për vite të tana, kriminelat që me maskën e komunizmit në fytyrë

Dritëhijet e kapitalizmit “Made in China”

Rezultate ekonomike spektakolare

Tashmë Kina vlerësohet si fuqia

e tretë ekonomike e botës. Mbasi “parakalo” me shpejtësi që në vitin 2005 Francën dhe Anglinë, mbasi “shkurorëzoi” nga podiumi i ekonomisë botërore Gjermaninë në vitin 2006, në fund të verës së këtij viti, ekonomia dhe zhvillimi i Kinës u renditën në vendin e tretë, duke pasur përpara tyre vetëm SHBA dhe Japoninë. Sipas vlerësimeve të ekspertëve, në vitin 2020 pritet që ekonomia kineze të arrijë dhe kalojë edhe ekonominë e Bashkimit Evropian. Në fund të vitit 2007, prodhimi i brendshëm bruto (PBB) kinez pritet ta kalojë shifrën e 3100 miliardë dollarësh (ose 2246 miliardë eurosh) kundrejt vetëm 3000 miliardë dollarësh që pritet të jetë PBB i Gjermanisë. Gjatë viteve të fundit, rritja ekonomike me dy shifra luhet në nivelet 10-12% duke e bërë Kinën vendin me rritjen absolute, por dhe ritmin e rritjes më të lartë në botë.

Investimet direkte janë rritur me një shifër vjetore prej 20-25% në vit, shifër kjo “e frikshme” për ekonomistët, natyrisht në kuptimin pozitiv të fjalës. Nga ana tjetër, inflacioni, armiku më i rrezikshëm i ekonomive në ekspansion kaq të shpejtë dhe kaq të lartë, vazhdon të luhet në shifrat e kënaqshme të 3-4,5% me gjithë dyshimet për kohëzgjatjen e kësaj periudhe të artë.

Por shifrat impresionuese të zhvillimit të Kinës shkojnë akoma më tej: në vitin 2007 Kina rezultoi si prodhuesi më i madh i perimeve në botë (48% të sasisë totale të perimeve në shkallë planeti); është ndërtesuesi më i madh në botë i autostradave, hekurudhave, palleteve dhe shtëpive të banimit, si dhe i hidrocentraleve dhe digave gjigante; fabrikuesi më i madh i kompjuterëve dhe televizorëve; çdo vit në Kinë prodhohen rreth 6 milionë vetura; vendi është prodhuesi dhe konsumatori më i madh i qymyrit, hekurit dhe aluminit në botë; 80% e traktorëve që prodhohen sot në botë janë të markës “made in China”; 70% të orëve të të gjitha llojeve gjithashtu.

Sipas vlerësimeve, pritet që në vitin 2013, prodhimi industrial kinez ta kalojë atë amerikan. Një tjetër “kuriozitet” në kuadrin e rekordeve kineze, këtë radhë në kuadrin e bumit të ndërtimeve: “në Shangai gjenden aktualisht rreth 30% e vinçave të të gjithë botës!” Origjina e ekonomisë moderne kineze - Për të kuptuar rëndësinë dhe peshën e ekonomisë moderne kineze mjafton t'i referohemi si periudhe fillestare në epokën ekonomike moderne situatës së shekullit XIX, në të cilin ekonomia e Kinës paraqiste 30% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të botës.

Në shekullin XIX, Kina kaloi një periudhë me tensione të forta sociale, me stanjacion ekonomik, me një rritje demografike eksplozive dhe probleme të shumta e konfliktuale në marrëdhëniet me “fuqitë perëndimore” të kohës. Dëshira e britanikëve për të “hapur” tregtinë dhe sidomos për të vazhduar “eksportet e ndaluar të opiumit” çuan në “luftën e parë të opiumit” dhe disfatën kineze të vitit 1840.

Me traktatin e Nankin-it të vitit 1842, Britania e Madhe përfitoi Hong Kongun, si dhe të drejtën e “hapjes” së shumë porteve kineze kundrejt tregtisë me Evropën.



Më vonë, SHBA dhe Japonia, përfituan njaft “koncesione” në kontrollin e territoreve bregdetare dhe privilegje të mëdha tregtare në Kinë. Fitorja e “Republikës Popullore të Kinës” në vitin 1949 shënoi fundin e një periudhe autarkike në ekonominë kineze dhe e orientoi atë drejt “ekonomisë socialiste” me planifikim krejtësisht të centralizuar dhe kontroll absolut të partisë në jetën politike, ekonomike dhe sociale.

Kjo periudhë u karakterizua nga suksese në drejtim të garantimit të një niveli të pranueshëm jetese e shërbimesh për popullsinë kineze, ashtu dhe nga “gabime të mëdha” si “Revolucioni kulturor”, “kërcimi i madh përpara” etj., të cilat ç’organizuan krejtësisht ekonominë, trashëgiminë historike dhe nivelin e jetesës në Kinë. Mbas vdekjes së udhëheqësit të revolucionit kinez, Mao Ce Dun në vitin 1976 dhe ardhjes në pushtet të një udhëheqësi më liberal, Ten Siao Pin-it, në Kinë u aplikua një formulë dhe koncept i panjohur më parë “ekonomia socialiste e tregut”. Kjo i krijoi mundësi Kinës të “hapte progresivisht ekonominë e saj pa prekur regjimin politik”. Ten Siao Pin-i deklaronte se “tregu i lirë është si një kanarinë e vlefshme dhe e bukur që duhet mbajtur në kafaz, sepse po e lë derën hapur ajo fluturon dhe nuk kapet dot më”.

Që prej viteve ‘80, Kina po njih një zhvillim të pandalshëm aq sa sot ka arritur të cilësohet si “uzina e botës”, ndërsa për të ardhmen, sipas ekonomistit Laurent Dupin ajo rrezikon të bëhet “qendra komanduese e ekonomisë botërore”. Hapja ekonomike e Kinës aktualisht mbështetet në të ashtuquajturat “zona ekonomike speciale”, zona apo territore që ofrojnë kushte shumë të favorshme për firmat dhe kompanitë e huaja nacionale apo multinacionale, por që paralelisht me lehtësirat “i detyrojnë ato të lënë në vend teknologjitë dhe instalimet e tyre në rast se vendosin të largohen apo delokalizohen”. Këto zona okupojnë tashmë pothuajse gjithë zonat bregdetare kineze.

Futja e Kinës në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) në vitin 2001 po e konfirmon përditë e më tepër vendin e Kinës në ekonominë botërore, duke e profilizuar atë si një qendër rëndëse në krah të SHBA, BE-së dhe

Japonisë. Eksportet kineze janë nga më kompetitivët në botë dhe përbejnë kontingjentin kryesor të deficitit tregtar amerikan. Kina zotëron sot edhe një sasi kolosale dollarësh. Me anën e rezervës së saj strategjike financiare Kina garanton 18 muaj importe dhe mbulon 10-fish borxhin e jashtëm të vendit.

Si pasojë e sificitetit të jashtëzakonshëm tregtar, Banka Qendrore kineze grumbullon dhe tërheq nga tregu financiar rreth 15 miliardë dollarë çdo muaj. Dilemat e rritjes dhe zhvillimit - Por edhe rritja ekonomike nuk është gjithmonë e dëshirueshme. Shqetësimi kryesor i autoriteteve ekonomike e financiare kineze aktualisht nuk është nxitja dhe përshpejtimi i mëtejshëm i rritjes ekonomike, por “frenimi i saj” dhe menaxhimi me kujdes i “mbinxhjes së motorit ekonomik të vendit”. Shifrat e publikuara nga agjencia kineze e statistikave, si dhe orientimet e Bankës Qendrore Kineze apo institucioneve të tjera përgjegjëse për zhvillimin ekonomik, duke u referuar gazetës “Le monde”, dëshmojnë se autoritetet kineze “kanë filluar të shtypin pedalin e frenave” për të frenuar ritmin e zhvillimit.

Rreziku i shfaqjes së inflacionit ka filluar të shqetësojë ekspertët e ekonomisë dhe financave në nivelet më të larta. Rritja prej 5,6% e çmimeve në përgjithësi në muajt qershor-korrik të viti 2007 (çmimet e shumë produkteve ushqimore janë rritur me 15% dhe çmimi i mishit të derrit dhe nënprodukteve të tij me 40%), më e madhja e 10 viteve të fundit, është bërë objekt analizash e reagimesh të veçanta në emër të ruajtjes së “stabilitetit social”. Ekonomistët dhe politikanët kinezë janë të ndarë në opinionet e tyre në lidhje me këtë valë të pritshme inflacioniste.

Pyetja dhe pikëpyetja më e rëndësishme që qarkullon në mjediset politike e ekonomike të vendit është: “tensione lokale dhe koniunkturale apo mosfunksionim strukturor që vjen si pasojë e mbinxhjes së ekonomisë?”. Por ky shqetësim, edhe pse nga ana e autoriteteve kineze shprehet me shumë kujdes, ka filluar të ngacmojë Bankën Qendrore Kineze, e cila në raportin e saj të fundit të muajit gusht 2007 tërhiqte vëmendjen “se presionet për rritjen e çmimeve janë forcuar dhe rreziku

i inflacionit meriton të ndiqet me vëmendje”. Raporti nënvizon gjithashtu se “duhet evituar që rritja shumë e shpejtë të shkaktojë mbinxhje të ekonomisë në përgjithësi”. Analistët presin që Banka Qendrore të realizojë një rritje të re të normës bazë të interesit, e cila do të jetë e katërta radhazi për këtë vit.

Kapitalizmi “Made in China”: mit apo realitet? Kapitalizmi specifik kinez është tashmë në fokusin e shumë analizave dhe diskutimeve në botë. Mjaft pyetje e pikëpyetje të tipit: “a ngjan kapitalizmi kinez me kapitalizmin anglo-sakson, social-demokrat apo atë shtetëror të njohur deri tani si forma dominuese të kapitalizmit në botë?”, “a mund të shërbejë si shembull kapitalizmi kinez për vende të tjera?” etj., qarkullojnë sot në mjediset politike dhe akademike ndërkombëtare. Por vetë kinezët pretendojnë që “modeli i tyre ekonomik” duhet të njihet dhe pranohet si origjinal. Modeli kinez nuk është një kalim klasik stricto sensu “nga komunizmi në kapitalizëm” siç ndodhi në mënyrë radikale dhe masive në vendet e tjera ish-komuniste lindore.

Kinezët e përkufizojnë këtë model jo si një “kapitalizëm komunist” ashtu siç e cilësojnë rëndom atë perëndimorët, por si një “kapitalizëm origjinal kinez”. Thelbi i tij është “kombinimi i autoritarizmit politik me efektivitetin ekonomik”. Sipas D.Haber dhe J.Mandelbaun “ekonomia socialiste e tregut” po shndërrohet gradualisht në një “kapitalizëm special kinez”. Forca e kapitalizmit kinez qëndron para së gjithash në fuqinë e tij demografike.

Popullsia gjigante kineze, e kontrolluar tashmë me ligje dhe rregulla të rrepta në progresin e saj, nuk është më një element frenues i zhvillimit, por “motori kryesor i progresit”. Drejtuesit e ndërmarrjeve dhe firmave më të mëdha të botës konstatojnë çdo ditë karakterin e veçantë të këtij burimi human, talentin dhe edukatën e punës, eficensën dhe iniciativën kolektive, respektin dhe sakrificën për punën dhe ndërmarrjen etj. Kina është aktualisht, por pritet të jetë dhe në të ardhmen, hapësira prodhuese më e kërkuar në botë nga ana e firmave dhe sipërmarrjeve të biznesit ndërkombëtar.

Dhe kjo, jo vetëm sepse Kina

po bëhet tregu më i madh në botë, por sepse ajo ka mundësi ta zgjerojë pa pushim hapësirën e saj “të dobishme për zhvillim” në veri dhe perëndim të territorit të saj duke mbetur kështu një zonë prodhuese nga më kompetitivët në botë. Duke përfituar nga territori gjigant dhe demografia intensive, Kina mund ta ruajë kompetitivitetin në fushën e çmimeve duke zhvilluar në të njëjtën kohë dhe kompetitivitetin në fushën e cilësisë dhe teknologjive të reja, të konsideruara deri tani “si pronë e Perëndimit”.

Në librat e tij të fundit, “Shekulli Kinez” dhe “Cindia”, gazetari italian, Federico Rampini, korrespondent qe prej dhjetë vjetësh i gazetës italiane “La Repubblica” në Kine, shkruan se “tashme kinezet po krijojnë gjigantët e tyre të super-teknologjive të tipit “micro-soft”, “apple”, “general motors”, “monsanto”, “silicon valley” etj.”. F.Rampini e vlerëson si shumë të rendësishëm momentin kur “keta shkencëtarë dhe inxhinierë në vendet në zhvillim do të fillojnë të drejtojnë sektorë që punësojnë masivisht fuqinë punëtore dhe që kanë impakt të konsiderueshëm në ekonominë rajonale e botërore”. Ky do të jetë dhe momenti me i vështirë për vendet e industrializuara, pasi ato do të humbin një pjesë të aftësive të tyre konkurruese si pasojë e humbjes se perparësive në teknologjitë e reja.

Mrekullia kineze dhe ankthi i shkatërrimit ekologjik Por mrekullia kineze ka edhe anën tjetër të medaljes. Ajo vlerësohet nga ekspertët si “antiteza e zhvillimit të qëndrueshëm”. Zhvillimi ekonomik po realizohet në kurrit të shkatërrimit të natyrës dhe shëndetit të njerëzve dhe si për ironi të këtij fakti, Kina është nga të pakat vende në botë që nuk ka akoma një Ministri Mjedisore! Sipas OECD-së “prioritetet ekonomike në këtë vend kanë lënë krejtësisht në hije preokupimet mjedisore”. Mjaftojnë vetëm disa shembuj për të provuar situatën alarmante mjedisore.

Kina ka aktualisht 17 nga 20 qytetet më të ndotura të botës dhe sipas OECD-së “në disa qytete ajo është në gjendjen nga më problematike në botë”; çdo ditë në Kinë shtohen në qarkullim më shumë se 3000 vetura; mbi 30-40% e ujërave mbiotkësore janë “shumë të ndotura”; për herë të parë në historinë e Kinës dhe planetit, në fund të vitit 2007, emisioni i dioksidit të karbonit (CO2) nga ana e Kinës (i vlerësuar si përgjegjësi kryesor i fenomenit të ngrohjes së planetit dhe ndryshimeve klimaterike) pritet ta kalojë atë të prodhuar dhe lëshuar në atmosferë nga SHBA.

OECD-ja citon një raport të fundit të Bankës Botërore mbi kostot njerëzore të ndotjes sipas së cilit, në Kinë “190 milionë njerëz vuajnë nga sëmundjet e shkaktuara nga përdorimi i ujit të ndotur...”. Qeveria dhe institucionet publike kineze po ndërmarrin një sërë programesh speciale për të sensibilizuar popullsinë dhe industrinë e vendit për të reduktuar në maksimum këtë proces gjigant ndotjeje dhe shkatërrimi të natyrës, aq më tepër që Kina ndodhet në prag të organizimit të Lojërave Olimpikë Botërore në vitin 2008, por duke ju referuar dhe vetë autoriteteve kineze, një ndërmarrje e tillë është e vështirë, sidomos respektimi i rregullave dhe ligjeve mjedisore nga provincat dhe sektori privat i ekonomisë.

Një shoqëri me shumë tensione sociale. Megjithëse nga jashtë duket sikur shkëlqimi ekonomik eliminon apo minimizon çdo problem social, shoqëria dhe realiteti shoqëror kinez mbartin shumë probleme e tensione sociale. Sipas burimeve zyrtare kineze, “çdo vit në të gjithë vendin llogariten rreth 75000 manifestime”. Pjesa dërrm-

uese e tyre zhvillohen larg syrit të gazetarëve dhe objektivitetit të kamerave të televizioneve, zhvillohen në zonat rurale të vendit në të cilat jetojnë 2 në 3 kinezë.

Fshatarët luftojnë kundër shpronësimeve dhe përzënies nga tokat bujqësore në emër të industrializimit dhe zhvillimit e modernizimit të vendit; minatorët kinezë bëjnë greva të ashpra në kërkim të kushteve më të mira e më të sigurta pune në minierat e qymyrit (Kina prodhon aktualisht 30% të sasisë së qymyrit në botë, ndërkohë që shifra e aksidenteve në minierat kineze të qymyrit përfaqëson rreth 80% të aksidenteve në këto miniera në botë); të papunët protestojnë kundër mungesës së sistemeve sociale mbështetëse; qytetarët e qyteteve të mëdha protestojnë shpesh kundër shpronësimeve arbitrare të banesave dhe pronave të tyre në emër të ndërtimit të lagjeve moderne etj.

Sipas Wen Tiejun, dekan i Fakultetit të Ekonomisë Agrare dhe zhvillimit rural të universitetit Renmin të Pekinit “të huajt i kanë të përqendruar sytë vetëm te shifrat e rritjes ekonomike...ata admirojnë pallatet tona shumëkatëshe gjigante dhe në mendjet e tyre mbeten vetëm metropolet ultramoderne... por janë hapësirat rurale kineze ku jetojnë mbi 700 milionë njerëz ato që kanë më shumë probleme”.

Sipas statistikave (enciklopedia Wikipendia), mbi 30 milionë njerëz në Kinë jetojnë akoma me më pak se 77 dollarë në vit; vetëm 76 milionë punëtorë urbanë ose 5,8% e popullsisë janë të mbrojtur dhe mbuluar nga sigurimet shëndetësore. Shoqëria kineze konsiderohet si një nga shoqëritë më të diferencuara të botës: familjet më të pasura që përfaqësojnë vetëm 8,6% të popullsisë në total, zotërojnë mbi 60% të kapitalit financiar të vendit. Po kështu, duke u referuar statistikave kineze, qendrat e mëdha urbane dhe aglomeratet industriale janë tre herë më të pasura se hapësirat rurale.

Një problem shumë shqetësues për ekonominë dhe shoqërinë kineze është dhe fenomeni i korrupsionit, sidomos ai i “kuadrove të mesëm dhe të vegjël”. Si pasojë e legjislacionit shumë të rreptë në këtë drejtim, Kina mban vendin e parë në botë për dënimet me vdekje apo dënimet e gjata me burg për “trafik droge”, “përvetësim fondesh dhe parash publike”, “shmangie nga detyrimet fiskale”, “klientelizëm” etj. Po kështu, një nga problemet më shqetësues për të cilat Kina është e “famshme” në botë, është “prodhimi pirat” i shumë produkteve e markave të njohura ndërkombëtare, fenomen që po bëhet shkak për shumë konflikte tregtare e politike ndërmjet Kinës dhe SHBA, BE etj. Atletet “Nike”, pantallonat “Jeans”, rripat e lëkurës “Levis”, bluzat “Lacoste”, kravatat “Armani”, veshjet “Nino Vitali”, çantat “Versace”, kozmetika “Lancom”, “Shiseido”, “L’oreal”, “Givenchy” etj., CD-të e filmave dhe këngëtareve më moderne e më në modë, veturat BMW, FORD, etj., gjenden tashmë të gjitha në versionin e tyre kinez dhe shiten pothuajse në të gjithë vendet e botës, megjithëse janë thjesht kopjime ilegale dhe shumë larg cilësisë së versionit dhe patentës origjinale.

EDISON MYRTEZA,
Pekin

Përkrenaria e Skënderbeut me titullin "Mbret/Rex i albanëve dhe epirotëve" dhe helmata epirote-maqedone në një monedhë të basileusit Trifon (142-138 para Kr.)

Agron Luka

KAQ PAK INFORMACION, PËR NJË TEMË TILLË!

Para disa ditësh, në Muzeun Historik Shkodër, u ndodha në një diskutim mbi përkrenaren e Skënderbeut. Në internetin shqiptar, në zërin e përkrenares ishte prezantuar një lloj krahasimi fotografik i përkrenares mesjetare të Gj. K. Skënderbeut me një tip helmate antike, simbas pamjes së skanuar nga një monedhë antike. (shih fig. 1)

Bashkëbiseduesi, krahas prezantimit të ilustrimit grafik nga kompjuteri, më drejtoi edhe këto pyetje: "A keni ndonjë dijeni për këtë monedhë, ku është gjetur, çfarë kohe i përket, cila ka qenë vendndodhja e këtij basileusit Trifon? Çfarë opinioni mund të jepni për analizën dhe konkluzionet që ka paraqitur ky autor shqiptar?"

[Në parantesë, unë kam njëfarë njohurie mbi disa tipe helmata të personazheve mitologjike dhe të basileusave antikë të gadishullit tonë, në disa paraqitje numizmatike, kam një lloj koleksioni modest dhe e kam pasion të memorizoj në kompjuter paraqitjet e monedhave dhe informacionet nga katalogët e internetit; kam botuar diçka për tema të tilla etj.]

Mbasi më kaloi impresionimi i parë, realisht mjaft befasesh e kurioz, fillova të llogjikoj për një opinion fillestar e relativ dhe i ktheva këtë përgjigje: "Me sa po shoh, këtu nuk jepet ndonjë referencë studimi. Sigurisht një temë e tillë nuk duhet të ishte si enigmatike! Nuk po shoh as emrin e autorit dhe as ndonjë informacion për vetë monedhën dhe ti ke të drejtë që i shtron këto pyetje. Duke gjykuar nga shkrimi alfabetik helen, nga dega me gjethë lisi, mendoj se kjo monedhë lidhet me një trashigimi epirote ose diçka e përzier epirote e maqedone. Një ide për bazileusin Trifon e kam dhe me sa mbaj mend e kam lexuar në Biblën e Vjetër, por duhet ta verifikoj. Gjithashtu, do të ishte e nevojshme të dinim se, kush i ka miratuar përfundimet e këtij krahasimi, përdërisa i kanë dhënë edhe një vend me kaq rëndësi. Më duket se me kaq pak informacione, krijohet një përshtypje e parë, sikur kësaj sinteze nuk mund t'i bëhen vërejtje, diskutime etj".

Unë kam bërë një shkrim në lidhje me përkrenaren e Skënderbeut. ("Marin Barleti kopjoi librin e Dh. Frangut apo anasjelltas?", gaz. SOT, 5 maj 2009) Aty kam shprehur idenë se përkrenaria si punim e si dhuratë mesjetare (pavarësisht nëse Gj. K. Skënderbeu, ka patur si dhurata simbolike, një ekzemplar ose dy të tilla), ngjan se, është unike në formën e llojin e saj. Duke diskutuar me mos-

besim pretendimin e studiuesit Lek Previzi, se Gj. Kastrioti na kishte patur dy përkrenare të tilla, njërin për luftime e tjetrën si dhuratë e simbolikë koleksioniste, unë e kam shprehur diskutimin se, përkrenaria me kokë e bri dhie nuk dokumentohet të ishte përdorur e mbajtur në kokë në betejë nga Skënderbeu. (shih fig. 2.)

Nga grafikët e para, nuk rezultojnë gjë e tillë, pavarësisht se si e paraqitën piktorët e më vonshëm, pavarësisht si e konceptuan dy rusët, skenaristi dhe regjizori, në filmin Skënderbeu më 1953 dhe pavarësisht se si ia ngjeshën përkrenaren, sidomos artet e "realizmit socialist-emverist".

Nga autorët antikë, nga Bibla e Vjetër, nga Kurani, etj, por edhe nga disa monedha e ndonjë medalion, krahas shumë tipeve helmata me simbole e mitologji të tjera, dijmë se tipe helmata me një bri ose dy brirë dhie mbante Aleksandri i Madh, Pirrua i Epirit. Edhe pasardhësit basileusa mbas vdekjes dhe shpërbërjes së perandorisë së Aleksandrit të Madh, mbanin përkrenare

40; VII, 45)

Dijmë se dega e lisit përdoret gjërësisht në monedhat epirote dhe gjithashtu e dijmë se popullsia ilire-alban-epirote e identifikonte veten edhe me emrin maqedon, jo vetëm sepse një pjesë e këtyre popullsisë përfshihej realisht në atë emërtim teritori, por edhe sepse e pretendonte trashigiminë e ish Maqedonisë, si fqinji më i afërt, si popull bashkëpjestar i një aleance gadishullore, filluar qysh nga koha e Filipit II, Olimpisë Epirote, Aleksandrit të Madh dhe Aleksandrit Mollos etj. (shih ilustrimet përkatëse nga paraqitjet e monedhave)

Në këtë temë e përkrenares, informacione e kontribute të rëndësishme nga autorët shqiptarë ka M. Sirdani, pastaj autorë të kohës socialiste dhe bashkëkohore, si K. Frashëri, L. Malltezi, M. Zeqo etj.

Tre prerje varjante të ndryshme të kësaj monedhe nga Basileusi Trifon (142-138 para Kr.) dhe disa çështje të tjera të hapura

Me gjithse fillimisht, kontrollova sa munda, nuk më kapi grepi ndonjë

e figura të njëjta me atë të Lekës së Madh, sepse e ka ditur se Leka ka qenë me origjinë ilire. Në monedhën antike që është në fotografi shihet përkrenaria e Lekës (Aleksandrit të Madh) dhe në fotografi majtas është përkrenaria e Gj. K. Skënderbeut të cilat kanë figura dhe elemente të njëjta". (Shih forumi Zemra Shqiptare, Zëri "Përkrenaria", postimi E enjte 02-12-2010)

Me sa kisha lexuar dhe sa kam patur dijeni, ky Basileusi Trifon përmendej në Biblën e Vjetër, te "Libri i Parë i Makabenjve", ku flitet në një mënyrë më të posaçme, mbi situatën, evenimentet historike, ndërrimet e basileusave etj, në teritorit e lindjes së mesme, nga Azia e Vogël, Siria e deri në Egjipt, mbas vdekjes së Aleksandrit të Madh. Dhe kështu e rilexova me vëmendje edhe një herë pjesën përkatëse në Biblën e Vjetër.

Kontrollova në internet dhe e gjeta monedhën në tre varjante, siç po e paraqes, pa ia luajtur as diçituarat në anglisht. (Fig. 8, 9, 10; Shih, "Forvm's Classical Numismatics Gallery - Greek and Greek Imperial Coins", në një ripostim të modifikuar, të kohës së fundit)

Rezultojnë se për inerci apo ndoshta edhe si ish origjinë, nga bazileusat që ndanë teritorit mbas vdekjes së Aleksandrit të Madh, ende ruhen traditat mitologjike, kulturore, besimi politeist i Zeusit, shtampat e simbolet e monedhave me prejardhje nga gadishullit ynë. Vetë vendndodhja e basileusit Trifon (142-138 para Kr.), stacionohet si zotërimi në lindjen e mesme, në

një zonë midis Sirisë dhe atyre ku mbaronin sundimet e pasardhësve të Ptolemejeve të Egjiptit. Basileusi Trifon kishte mundur Antiokun VI (145-142 para Kr.), duke ia marrë edhe mbretërimin, por më 138 para Kr., vret veten i mundur në një betejë nga vëllai i Demetrit II.

Në këtë "krahasim-analizë" dhe "konkluzionet", e sintetizuara të internetit tonë, konkretisht me një frazë, pretendohen nga dr. Ilmi Veliu, tre përfundime, si më poshtë:

Diferencë-kronologjia rreth 2000 vjeçare, nga monedha të përkrenaria mesjetare, merr për bazë një përkrenare të tillë të Aleksandrit të Madh.

Te përkrenaria e Skënderbeut (e njëjta përkrenare?!) kemi një imitim-kopje nga kjo formë helmate e monedhës antike.

Të njëjtat simbole te dy rrathët e shënuar me numërin 1; dhe te koka e dhisë me brirë të shënuar me numërin 2. (?)

VËREJTJE DHE MENDIME NDRYSHE

Për mendimin tim, në lidhje me

përfundimet e mësipërme kam disa vërejtje dhe ndonjë shtesë:

Ka sigurisht një lloj baze e arsyetimi për një krahasim, porse më produktive dhe më e justifikuar do të ishte, sikur krahasimi të ishte bërë me një artefakt helmate/përkrenare antike maqedone, ilire, epirote etj. Dhe deri më sot nuk kemi ndonjë gjetje arkeologjike të një përkrenareje identike të tillë me përkrenaren punim mesjetar dhuratë për Gj. Kastriotin. Kronologjia rreth 2000 vjeçare, plotësohet duke patur parasysh pjesërisht Aleksandrin e Madh. Por, të kuptohemi se, ka edhe para këtij tradita të tilla, por këto nuk ceken në rastin në fjalë. Pra, kjo ende hipotezë duhet vërtetuar me një artefakt tjetër të sigurtë!

Nuk kemi informacione dhe asgjë të garantuar, që Përkrenaria e Skënderbeut të ishte punuar në mesjetë duke imituar konkretisht formën e monedhës së paraqitur të shek II p.e.r. Për më tepër akoma nuk kemi informacione e përfundime të sigurta, nëse këtë përkrenare Skënderbeut ia dhuroi Papa Piu II apo Ferdinandi i Napolit(?). (Shih në HS, f 418-421) Ka patur edhe ide se kjo përkrenare kishte një origjinë punimi nga orjenti, ose nga një mjeshër orjentali.

Nuk rezultojnë me aq siguri se, te pjesët e shënuara me vizë 1 e 2, kemi të njëjtat simbole, siç shihet edhe nga një këputje pjesëve konkrete dhe të zmadhuara.

Koka e dhisë është një derdhje në bronz e larë me ar. Kjo derdhje nuk rezultojnë e sigurtë tek monedha konkrete dhe tek varjantet e tjera të saj dhe kështu kërkon mendim autoritetesh kompetente dhe teknika të sofistikuar.

Edhe simbolet brenda rrethit, nuk duket se janë identike/të njëjtat! Në Përkrenaren e Skënderbeut, siç e theksojnë K. Frashëri dhe M. Zeqo, ka një shtesë të mëvonshme (?), një lloj fashature/tripi bakri i larë në ar, i montuar me përçina, ku janë në formë rozete gjashtë petale luleje dhe gjashtë monograme sekrete. Për deshifrimin e tyre ka shkruar fillimisht edhe M. Sirdani e më pas ripërsërit prof. K. Frashëri. ("Ju rrefej armët e heroit", 9 shkurt 2005)

Prof. dr. M. Zeqo, me disa luhate e shënon se, Skënderbeu nuk e ka patur titullin "Mbret-Rex i albanëve e epirotëve". Por, këtu duhet të mos harrojmë se, ky titull i ishte premtuar, madje edhe shumë më tepër! (përse nuk i janë bërë analizat radio-karbonike asaj larjes me ar?!). Gjithsesi, edhe po ta marrim si të mirëqenë se rripi me monogramet e kishin shtuar pasardhësit, do kishim aty një konfirmim "sekret", për atë ish premtimim aq pompoz si: "Kapiten i Përgjithshëm i Kryqëzatës, si Mbret i Albanisë, Epirit, Maqedonisë, Thrakës e madje edhe i Romës së Re"! Ky premtim i Papës Piu II, reduktua së fundi, para se të imbarkohej në Ankona, thjeshtë si "Mbret i albanëve dhe i epirotëve", por edhe ky rezultoi i pa mbajtur me



-2000 vjete diference, perseri te njejtat simbole, dhe e njejta perkrenare

Ilustrimet e tjera grafike do të pasqyrohen në faqen tonë të internetit

me brirë, mbanin simbole me shqiponja, quheshin me epitete si të tillë. Kurorëzimin me degë me gjethë lisi e gjejmë si traditë të epirotët edhe te maqedonët etj. Pirron e Epirit, ushtarët epirotë e maqedonë e quanin shqiponjë dhe ai shquhej edhe si rritës ushqyes e stërvitës shqiponjash. Por Pirrua mbante edhe përkrenare me brirë çjapi, siç dëshmon Plutarku. Plutraku tregon dhe e thekson se, maqedonët e shpallën Pirron edhe si mbret të tyre dhe ia kurorëzuan kokën me dega me gjethë lisi, sepse ashtu ishin kurorëzuar të gjithë ushtarët epirotë. Aeliani vëren se Pirroja gëzohej kur ushtarët e thërrisnin shqiponjë, po ashtu siç e thërrisnin edhe Antiohun si skifteri. Dhe ky Antiohu ishte një basileus në lindjen e mesme. Të kujtojmë se edhe vetë Pirroja ishte shkolluar në Aleksandri te Ptolemejtë etj (shih, Plutarku, "Vitae Parallelae", Pyrrhus, 10,1, 11,8,9,10,11; Aeliani, "De Animallum Natura", Lib. II,

lloj studimi rreth këtij autorit që e kishte paraqitur shkrimin në internetin shqiptar!

Por, papritmas me dt. 29 shkurt 2012, vura re se interneti kishte bërë një përmirësim minimal, kishte shtuar disa rreshta. Kështu m'u desh të përshtatja edhe unë shkrimin tim. Informacioni dhe krahasimi për të cilin flasim, ka autor dr. Ilmi Veliu dhe titullohet, "Leka i Madh (Aleksandri i Maqedonisë ishte me origjinë ilire". Ndër të gjithë rreshtat e cituar shkruhet kështu: "Kryeministri i Sllavomaqedonisë Nikolla Gruexi ka urdhëruar që Lekës së Madh ti vëhet një shtatore në mes të Shkupit e cila do të jetë e lartë mbi 20 metra. Si duket Nikolla e ka kuptuar se maqedonasit në Maqedonine Perendimore janë shqiptarë ortodoks dhe se përmendorja e Lekës në mes të Shkupit do të përfaqësojë kulturën shqiptare dhe jo atë sllave. Edhe Skënderbeu me përkrenaren e tij ka pasur elemente

Shkoder: A dynamite explosion in Mashku family, no casualties

A powerful explosion woke the residents of the street "Zenelaj" in "Ahmet Haxhia" of the northern city of Shkoder, in the early hours of the morning of February 7, 2016.

According to the preliminary sources, an amount of 200 grams of dynamite has exploded in the courtyard of the apartment of Sami Beqir Mashku. Under the roof of that dwelling house are living two families Sami Mashku and his wife Remzie Mashku and the family of their son Elvin Sami Mashku with

his wife Elsona Mashku and their son Enes Mashku.

The blast has caused material damage in the front of the wall, near the door, but no other casualties.

This serious event occurred about 04:10 minutes dated February 7, 2016, where unidentified persons threw the explosive materials and have rapidly moved away from the crime scene. According to a conversation with a forensic specialist, it is a terrorist act and those who have left explosive materials have calculated the length of wick fuses

to have enough time to leave until the sparks go to capsules detonators. We learn that Mashku family, although of the Muslim faith, has attended for many years the Catholic Church and the extremists of the Muslim faith have aggravated their actions. They have warned several times that family to pray five times a day and go to the mosque, or they will be killed. In fact, a year ago, terrorists put TNT to the family-house of the father of Interior Minister Saimir Tahiri, a pharmacist, Bashkim Tahiri and the terrorists

still have not been convicted.

Even this case of two families in Shkodra, Sami Mashku and Elvin Mashku, father and son, have had a negative impact on the citizens of Shkodra, since that night



two families were forced to leave home and live underground. Ordinary citizens do not have the means to cope with the possibility of such serious events. The family of the minister and his father today are protected by the secret police of the State, while the case in question of these two families in Shkodra and all innocent victims of Islamic terror, must cope with themselves. They should find a way to survive, or the findings are fatal. Either they are killed, or living underground. Only in the last 20 years, according to the newspaper Corriere della Sera, in Albania there were killed over 20,000 innocent Albanians.

The Editorial Office

The Democrat Anton Gjokaj endangering his life

Several months have gone since the local elections of June 21st, 2015, which were won through violence by the Socialist party, successor to the communist party. Those elections were full of terror, violence and bullets. One of the victims of the battle to protect the freedom of votes is the Democrat An-

ton Sokol Gjokaj, born on July 3rd, 1996 in the village of Pjetrosan of the municipality of Great Highland. This person today is forced to stay in hiding after the government gangs seek to eliminate him physically. Anton Gjokaj, a prominent Democrat, who supported the candidate for mayor of the Democratic

Party, Anton Kokaj, during this tough election campaign, was severely physically violated by the Socialist Party gangs. On June 14th, 2015, a week before the election day, two masked men, thugs of the state party, have suddenly stopped him on Bajza of Great Highland and have beaten him badly, leaving him unconscious and they warned him, that they would kill him, if he supported the Democrats. He was treated in the emergency Center of Kastrat, and now he fears, there-

fore he is living underground. This Democrat activist has invested for a society with the human rights and freedoms, he comes from a persecuted family by the communist regime of Enver Hoxha. The uncle of his father, called Gjok Pjeter Gjokaj, has been sentenced to 30 years in political prison in the remote year of 1945. From his family, there have been other political prisoners and internees and their real estate has been sequestered.

Anton Gjokaj and his parents have contributed for the Albanian

Democratic Party as activists, but unfortunately today they are suffering the consequences of the revenge. Political killings in Albania are numerous. It is here in the Great Highland, ten days before the parliamentary elections of June 28th, 2009, it was killed by explosives the Chairman of the Democratic Party of Great Highland, Aleksander Keka. He was killed by the gangs of the Socialist Party, precisely those gangs have beaten and threatening to kill the young man, Anton Gjokaj. The Editorial Office

Klementiana, fortesa apo kështjella që u shua ndër shekuj për ti lënë amanet emrin fisit të kelmëndit

Nga Ndue Bacaj

Në trojet e Malesise Madhe (si edhe në ato të Shqipërisë) ndër shekuj kanë lulzuar ndertime civile e mbrojtëse, të cilat në thelb shprehin qytetrimin dhe zhvillimin e kesaje pjese nga më shqiptaret e Shqipërisë Europere-dimore. Rrebeshet e moteve që kaluan ndër keto troje shpesh rrafshuan, qytete, qyteza, fortesa apo kështjella, por nuk rrafshuan kujtesen e Malsorve per historin e tyre, e cila pervec gojdenave, legjendave, dokumentacionit apo historise së shkruar, kanë si deshmi qytetrimi e zhvillimi, rrenoja, themele, gurë dhe shenja objektesh të ndryshme, të cilat vendasit i njohin, dhe kanë trashiguar historinë e tyre nga njeri brez në tjetrin, edhe pse mbi keto kanë kaluar, qindra apo mijera vite.

Kështjella Klementiana ose shqip Kelmendi është e njohur të pakten që në shekullin e VI, ku per ketë shkruajin historian, albanolog dhe studiues të huaj dhe vendas. Studiuesi dhe Albanologu i njohur Milan Shuffaj, per Fortesen apo Kështjellen Klementiana nder të tjera shkruan: "Mbas shekullit VIII zhiduken ngadale të gjitha kështjellat romako-bizantine të cilat nuk moren karakter qyteti. Duket më së shumti qendroi fortesa Klementiana (te Prokopi)... Në shekullin e XVII nga ky fortifikim merr emrin fisi shumë i forte i Klementineve (shqip Kelmendi)... (Serbet dhe Shqiptaret fq.15). Studiuesit shqiptare Lekë Rrotani dhe Palokë Rrotani në studimin e tyre me temë: Kelmendi

dhe Kelmendasit (mbi vjetërsin e banimit në Kelmend, mbi prejardhjen e kelmendasve dhe mbi vazhdimësinë e banimit ketu) nder të tjera në studimin e tyre mund të lexojmë: "...Vijme tash tek shekulli VI pas Krishtit. Nuk kemi perse lodhemi e të kerkojmë dokumente të shumta. Dekumenti më i sigurt është vepra "De aedificias" e Prokopit nga Çezareja që permend Kështjellen e quajtur KLEMENTIANA, të cilën e vendosë diku në thellsi të maleve veriore shqiptare. Deri më sot nuk është perkaktuar ende saktësisht vendndodhja e kesaj kështjelle me gjithë hipotezat e ndryshme. Ne mendojme se perderisa ai e quan Klementiana dhe Kelmendi që po marrim në shqyrtim ne, ka vazhduar jeten në ato rrethina, perse të mos e kerkojme ketë Kështjellë brenda Kelmendit, çka do të vertetonte kështu më së miri vazhdimësinë e banimit aty? Ndonse mund të duket kjo një hipoteze e jona, ne ngulim kembë se kjo kështjellë gjindet në VUKEL të Kelmendit. Permbledhtas po themi se ketu kemi zbuluar një vendbanim - kështjelle me mure rrethues 1526 metra, me dy porta hyrje (njera nga të cilat e mbyllur me gurë më pas) dhe me dy kulla mbrojtëse. Ketu kemi mjaftë gjetje arkeologjike: Qeramikë, armë e vegla hekuri dhe dy monedha bronxi të shekullit II - III pas Krishtit. Brenda rrethimit ka banesa me një urbanistike të rregullt..." (Shkodra ndër Shekuj fq.284-285, VII. II. fq.284-285, Muzeu historik Shkoder 1998.). Per ketë studim interesant vlen të sqarohet se Prokopi i Çezares

ka jetuar dhe shkruar gjatë shekullit gjashtë pas lindjes së Krishtit, gjë që e bënë të besueshme ekzistencën e Forteses apo Kështjelles së Klementianes në trojet e Kelmendit dhe konkretisht në Vukel, ku muriet dhe rrenoja e kesaje Kështjelle shihen edhe sot, si dhe per keto ka trashigimi gojore të bollshme në Vukel dhe krejt Kelmend. Gjetjet arkeologjike të sipercituara që i perkasin shekullit II - III vertetojnë se fortesa apo Kështjella e Kelmendit ka ekzistuar ndoshta edhe më perpara shekujve II dhe III-të pas Krishtit, si dhe na bejne të mendojmë se kjo Kështjelle ka sherbyer jo vetem si fortese apo kompleks fortesash per qellime ushtarake të perandorise Romake, por ka pasur edhe karakter të një qytetrimi civil, gjë që na jep të drejtë ta quajmë jo thjeshtë Kështjelle, por një qender urbane që me nivelin me të vogël ishte Qytezë. Natyrisht muriet dhe rrenoja që shohim sot në Vukel janë deshmia më e gjallë e një qytetrimi dhe zhvillimi të Trojeve të Kelmendit, ku duke ditur historinë e Kështjellave - qyteza apo qytete të mbretërisë (shqiptare) të Ilirëve, të pakten që nga Teuta e deri te mbreti Ilir Genci (apo Genti), ne themi se Kështjella në trajtat e një qyteze në Kelmend me emrin e njohur në histori Klementiana, duhet të kenë një moshë rreth 2250 vjeçare. Kjo moshë e kesaj Kështjelle na bënë që të themi pa droje se gjatë luftave mbrojtëse të mbretit Genti (apo Genci, që perdoret shpesh) me ushtritë (pushtuese romake) duhet të ketë qenë objekt sulmi dhe qen-

dre, por edhe shkatërrimesh deri në kohën e pushtimit romak (viti 168 para lindjes Krishtit). Ndaj duke pasur parasysh keto lufta dhe pushtimin romak, (që me sa duket e rikonstruktioi Kështjellen Klementiana per qellime të vetat) ne mesojme per historinë e kesaje Kështjelle apo fortese vetem nga shkrimet e shekullit VI-të, të Prokopit nga Çezareja, që jetonte dhe shkruante nën Perandorin Romake... Është me vlera te citohet edhe studiuesi i njohur Ermanno Armao që në një botim të tij shkruan per Kalanë e Kelmendit duke ju referuar një Kleriku e studiuesi shqiptare, ku ndër të tjera lexojme: "...Atë Rrok Gurashi ka vertetuar per mua me mirsjellje se e quajtura

Kala e Kelmendit është e rrethuar në perendim nga Maja e Rriskut, në lindje nga Maja e Shenikut (Shenkollit) dhe në jug nga Maja e Kllogjens..." (Vende, Kisha, Lumenj, Male e Toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore, Fq.157.), (Harta është e Hartografeve Coronelli dhe Cantelli të shekullit XVII, N.B.).

Në favor të ekzistences së Kështjelles Klementiana në Vukel shprehet edhe ish konsulli francez në Shkoder HEKARD (Hecquard) në mesin e shekullit XIX, ku ndonse ai nuk i "vrojton" rrenoja e saj, ndër të tjera shkruan:

"Jo larg Vuklit, ndodhej siç thonë një Kështjellë e fortifikuar, nga e cila sot nuk gjendet asnjë gjurmë, dhe disa vjet më parë një banor i ketij fshati, duke mbjelle një hardhi gjeti disa monedha ari të kohës së perandoreve Kostandin

dhe Valentin..." (Hyacinthe Hecquard... HISTORIA DHE PERSHKRIMI I SHQIPERISË SË EPERME OSE I GEGERISË, fq.176). Studiuesi dhe Historiani Atë Marin Sirdani (me orgjinë nga Boga), në librin "NDRICIME TË HISTORISË, TË KULTURES DHE TË ARTIT SHQIPTARË, në faqen 222, duke shkruar per "HEROINAT E MALEVE", gjatë luftes antiotomane (shek.XVII), tregon se: "GJYTETEZA E KELMENDIT, është vendi ku ishte fuqia më e madhe e Kelmendit, dhe ku mblihdeshin kuvendet, madje në keto kuvende merrnin pjesë edhe gra e vajza, që ma se një herë kishin ra në luftë dhe ishin da me nderë, ku një ndër keto heroina kishte qenë edhe Nora (e Kelmendit) që vrau pashen turk... Mirpo ky autor Qytezen e vendos në Nikç e jo në Vukel, gjë që na bënë të mendojmë se mos vallë ka pasur një Qyteze (me fortesen perkatese) edhe në Nikç, apo është një lapsus... Në shkrime të ndryshme thuhet se Kelmendasit e moren emrin nga Kështjella, ku disa studiues ketë e perkacojne teper vonë, pra në shekujt e XVI - XVII, gjë që nuk perkon me realitetin, pasi Kështjellen Klementiana, dhe emrin e Kelmendit e takojmë shumë më heret, ku ndoshta per disa shekuj "të parë", pas lindjes së Krishtit, kështjella Klementiana ka qenë qendra e qytetimit dhe zhvillimit modern bshkohore per vetë banoret e ketyre trojeve me emrin dhe historinë e madhe të Kelmendit, e njohur kjo kombetarisht dhe nderkombetarisht... Sidoqofte ne Malsorve në pergjithsi dhe kelmendesve në veçanti na kanë mbetur thjeshtë si deshmi krenare muriet dhe rrenoja që shohim sot në Vukel, si dhe gojdenat që trashigohen pa pushim nga njeri brez në tjetrin, por edhe këto duhen ruajtur në perjetsi, si deshmi qytetrimi e zhvillimi...

pabesi dhe u mbulua e u justifikua me mister me vdekjen e Piu II... Papa Piu II u katandis aso kohe aq i dëshpëruar, sa edhe t'i drejtohej me letra vetë Mehmetit II, ku ia premtonte kurorën e perandorit të Romës së Re, me konditë që ky të kthehej si kristian, madje madje, letra me lutje të tilla, simbas Barletit, i dërgonte Sulltan Mehmetit edhe vetë Skënderbeu. Por, do të guxonte një prift meshtar i thjeshtë të shtonte një histori të tillë të trilluar me emrin e Papës, aq më tepër ta improvizonte me atë "stilin tuqdidik"?!

[Në një letër drejtuar Papës Benedikti XVI, "Shoqata Dukagjini" dhe "Shoqata Integrimi në Europë", me anën e një studimi të Agron Lukës, kërkuan që arkivistët e Vatikanit të ndihmonin në

zbardhjen e kësaj enigme dhe pyesnin nëse ishte e mundur brenda kanonikëve kishëtar që, Kurora mbretërore e premtuar Skënderbeut dhe grada kardinal Pal Engjëllit, t'i akordoheshin në mënyrën retrospektive e honorifikim, pa cënuar absolutisht rendin republikan të Kush-tetutës së Shqipërisë. Me anën e Nunciaturës Apostolike, me dënimin e vetë Papës, ne morëm një përgjigje inkurajuese siç e vërteton edhe Shkresa... Por me sa duket burokracia e Vatikanit, mbase e ka harruar...!]

Megjith atë pak "ironinë" e z. I. Veliu, nuk mendoj se z. Gruovski dhe akademikët sllavomacedonas po e bëjnë shtatoren e Aleksandrit të Madh, thjeshtë e vetëm për hatrin e disa fshatrave me ca pak minoritete, disa qindra

ortoksë shqiptare të Maqedonisë Perendimore! Po myslimanët shqiptarë, pse i harroni dhe ku i fusni ju zotëri?! Unë besoj se Gruovski dhe ata që mendojnë si ai e bëjnë këtë për të treguar se në popullsinë sllavomacedone e bullgare ekzistonte ende një lloj trashigimie e ish popullsisë maqedone autoktone, se në Maqedoni vetëm gjuha ishte sllavizuar etj, fantazi jo shkencore si këto! Fakti që sllavojgorët dhe bullgarët e maqedonasit sllavojgorë janë të ardhurit e shek VI e më vonë, nuk mund të shpëhet me asnjë akrobaci, sado të lartë ta ngrejne shtatoren maqedonasit e sado ta lajnë edhe me ar Aleksandrin e Madh, megjith Bukefalini, kalin e tij! Pjesët e luanit nga ish trashigimia e shuar e Maqedonisë antike, kanë të drejtën t'i

pretendojnë vetëm popullsitë fqinje autoktone. Dhe ky është një fakt historik i pretenduar në vazhdimësi, sidomos nga populli alban/epirot-shqiptar. Nuk duhet harruar e anashkaluar gjithashtu nga historiografia shqiptare se, Sulltan Mehmeti II, Khalif, ia kishte falur Skënderbeut atë "bukëshkaljen dhe shpalljen qafir". Përndryshe përse do merreshin e do nderoheshin, me urdhërin e vetë Sulltan Mehmetit II, "me respekt shumë të madh e me frikë perendie/të All'lahut", eshtrat e një qafiri për hajmalira të shenjtat?! Ne, për më tepër patëm hedhur edhe një hipotezë se Mehmeti II i ngriti edhe një Tyrbe, Skënderbeut në Lezhë.

Këndej kanë më të drejtë ata autorë që Gj. K. Skënderbeun e shohin edhe si

heroin nacional që i përket të gjitha besimeve dhe rrymave të tjera në Shqipëri. Le të nxjerrin ato pak mësimë që mund të nxirren nga historia jonë e hidhur qarqet e larta shqiptare por edhe ato europiane. Me sa duket, siç e shpreh Kadare, kasta e lartë politike shqiptare ka qenë e gatshme të plotësojë me urgjencë e nostalgji vetëm standartet e "Dërgatës së Xhedahut", ndërsa preferon të zvarisur me "darka krokodilësh" e "studime fizibiliteti" për standartet europiane! (I. Kadare, "Mosmarrëveshja...", f 29-31 etj)

Këtu me kaq duhet ta mbyllim, për ta vazhduar ndonjëherë tjetër...

Real consideration of man, an important moment in our country's life

By Arjan Th. Kallço
Docent of "F. Noli" University of Korçë

Considering man today on the basis of true, impartial and real criteria is one of the most immediate duties of our country. In all these years, blinded of political hatred between similar, democracy, at least, shouldn't accept such things, the consideration of man was equal to zero. We're considering every past with an unusual collective attack, just as if all the wrong came from the past, while it's a long time we've forgotten the attack to all the today's problems. Even when there's an attempt, it's suffocated by returning to the past. As if the past could raise again. Even if it could, for many similar sides, it was said that history repeats, may it never occur, the attack would always go against the system, the regime, people who represented it. So, attack the past so that you will be attacked when far away from today. The head of these deformations is politics, as always, as it cannot accept and make right consideration of man. Today we're hearing and reading about superlative considerations, as if everything goes fine in Albania and

we're the old-time lighthouse enlightening the world. Yet, the latest joke is the enormous evaluation in schools and universities. By the beginning of the year, the University of Tirana makes an initiative delivering forms, which were then filled by students. It seems like the mentality of dossiers is still fresh in men's minds, those who have never considered good man. Then, the news was spread all around, after the forms were filled, docents had failed.

Is such an evaluation necessary? I have many reasons to think that docents shouldn't be considered and evaluated in this way. But, it appears like there's something wrong even in electing, that's why files are ready.

Firstly: the hard situation in the country, still because of politics, points out the fact of the docents' files to use them, when civil disobedience rises because of consciousness, if that will ever happen one day. I hope every one will be conscious one day that school has no political debts to pay, just a noble mission.

Secondly: can the student evaluate the docent?! I don't know from which evil mind this initiative comes, but it's re-

ally evil-minded, for the universities and their mission for knowledge and culture are kept in hostage. So, the university isn't given freedom to lead science and culture, but should accept the dictatorship of politics and its mad reformations. Let's just remember that the Ministry of Education changed again the graduation exams, right after the Prime Minister declared failed the reformation in education system. A conscious government should understand that when it fails in this sublime mission, it failed in the future of the country and the only way is to leave government in a civil way, without waiting until the end of the mandate.

Thirdly: docents are evaluated by students pressured by politically declared parents, so that the consequence of "their wrong" evaluation would be the right punishment.

Fourthly: the party's member within these universities would fear this evaluation and would respect the directives of their party, keeping this way the docents far from the numerous problems of this country.

Should such an evaluation be accept-

ed? I met students who filled the form, and this wasn't done openly, but in secret, as they were really embarrassed, at least those who have consciousness. A docent might even consider servile the fear of an evaluation, or even maximal evaluation, but who is evaluating? It's his students, and madness is quite clear here. In Italy, at least at the university we've often visited, we did never hear about "such initiatives". There might be in another country, but it is hardly accepted, for docents are the cream of science and culture and not recommended for that work just as if they didn't deserve it. During my conversation with students, I refused such evaluation, for the only reason that I don't accept such an evaluation. It seems like neither other institutions would escape evaluation, which I would consider subjective, as we're used to evaluations made by ignorant party members. May God help us...!

Let's hope others won't become prey of political instrumentalism like many predecessors whose evaluation takes only one side, that of the party, "either with us, or against us". Should we accept such an evaluation?

In Albania the law is made by drug gangs

In 1992, when the communist system was overthrown in Albania, the people dreamed about a free and democratic life. But there were the sons of communists who created bands and filled Albania with drugs. Drug gangs created links in every sector of the state and society, even killing those who worked for a normal state. This was also the case with the former police officer of the Rapid Intervention Force (FNSH) in the Prefecture of Shkodra, called Y.D, born on 14 May 1978. He had participated in several Cannabis Sativa destruction operations and was specialized, where he had also received a Stage Certificate from French Police Inspectors during the trainings. But the drug mafia, having the informants in the State Police, got data. Y.D had been in the red circle to be killed, for the reason of working honestly and refusing to

cooperate with drug growers. So pressures began, and in 2006 he was forced to quit the job as a police officer, simply to save his life. But the heaviest threat comes on May 2015 from Marjan Nikë Rripa, who tells former police officer Y.D that he has destroyed a drug parcel, ruining his business. Finally, Rripa has defined two solutions to former police Y.D. He has told him to pay the damage each month until he recoups it, or the Kanun law will be respected, where he will kill him and his sons. The laws of the Medieval Kanun of Lek Dukagjini are applicable even today in Albania. So, according to the Kanun, Rripa has isolated only Y. D. and his sons, that means they must stay inside and not to leave the Tower of Isolation. We learn that the former police started to move very carefully, but one day, exactly on 19 August 2015, around 15:00, in the "Vojo Kushi" neighborhood of Shkodra, near Radio Shkoder, former police officer Y.D and the drug grower Marjan Nikë Rripa have confronted each-other face-to-face. Rripa told

him: "You are so brave to move in the city, do not respect the law of the Kanun, and do not stay locked inside" and pulled out the knife and stuck it to the left side, somewhere near the heart, to kill him. The witness at the scene was the citizen Gezim Çelepja. After the grave incident, the criminal has fled calm, while the victim has ended up in the regional hospital of Shkodra, where lucky and thanks to the specialized care of doctors, there have been no problems for life.

The events went wrong, as although the criminal was denounced in the Prosecution and his file was transferred to the Shkodra District Court, he came up with a minimum penalty. After this incident, attempted murder, which shook the northern city, former police officer Y.D was forced to live hidden and there is time since no one knows his address. He has disappeared to save his life. Now his life and his sons have been introduced into the red circle to be killed.

The Editorial Office

Islamic terrorism has bases in Albania since 1989

Foundations of communist dictatorship were shaking. protests were launched in Shkodra and Kavaja and the few priests who had escaped alive like Dom Simon Jubani, Çesk Ashta, Mikel Koliqi, Ernest Troshani and any other, were organizing the believers to keep the wafer after a long period of communist dictatorship had brought abolish of the religion. There were Rin Monajka, Aleks Keka, Vitor Pukri etc. in northern Albania, were priests supporters to restore the religion. Here we saw the first clashes not only with the communist regime, but also with elements of Islamic terrorists. Using poverty, in the distant of 1989, the terrorists paid elements to create terror situations. They threatened the young people like Rin Monajka, who was later killed, Aleks Keka, who was also later killed, they threatened even Vitor Pukri, who spent many vicissitudes and lived some with no address, fearing really that he could be killed by terrorists. Homicide TNT in the car of Aleks Keka, which erupted in 2009, was declared by the Speaker of the Albanian Par-

liament of the time Jozefina Topalli, as a murder of religious act of Islamic terrorists and state structures even today have not investigated as they should, which shows on the other hand the political support of terrorist elements. Vitor Pukri passed the ordeal of terror with his life and late on September 27, 2008, his brother named Filip Pukri, at a place called "Arch of Bërdica", about two kilometers away from the northern city of Shkodra, had been threatened to death by H. Shqau, who on behalf of Allah told him that he would kill him, if he does not give the address of his brother, Vitor Pukri. Since that time until today, having spent nearly 7 and a half years by now, the family Pukri left empty homes and took streets as they could to save their lives. They left Albania. We learned that they had made reports to the police about their case and the Nationwide Associations of Reconciliation of blood feud intervened, but without any result. Our country is not only



weak, but also foreign intelligence services of Western countries managed to arrest over 20 Islamic terrorists in the last period of time, mainly imams, who have recruited fighters for ISIS and sent them to Syria, and with all the facts the international agencies have submitted to the Albanian and Kosovo's courts, the situation seems to be uncertain. They are delaying the investigations, dragging on forever.

It is a really heavy situation, where Islamic terrorism is installed also in the structures of the state police, apparently in order to keep strong corruption and suppression of human rights and freedoms, ranking Albania as a small country one of the first countries in the world as it is by its population for supplying the terrorist organization ISIS fighters in Syria and more.

The Editorial Office

Property conflict in Malësi e Madhe (Great Highland), Rrok Arra was killed

Ownership issues are taking many innocent people's lives. It is this the worst plague of the Albanian society. This phenomenon is more pronounced in Northern Albania, which also has recorded the highest number of victims. Hoti village encountered yesterday evening a conflict of property, where Lek Celaj, resident of the village Hoti shot dead by gunfire the citizen Rrok Arra, resident of the village Dukagjin. This serious event with a death person occurred in a bar of the village Hoti, in a distance no more than two kilometers from the Customs Hani i Hotit border point. From a rapid information, our newspapers learned that on that place, the killer Lek Celaj's nephews had built a bar, and the killer and the victim had a property conflict. Last night, the conflict has degenerated to murder, where Lek Celaj killed with firearms the so-called Rrok Arra. Police officers were notified and arrived quickly at the scene, accompanied by the regional hospital ambulance. Ambulances took the lifeless body of citizens Rrok Arra, as police escorted to the police station several people involved in the ownership dispute. It's been announced that the perpetrator is armed and has managed to escape in an unknown direction.

The Editorial Office

Marsi dhe shqiptaret

Sabir Krasniqi

Sipas shumë studiuesve eminentë të huaj e shqiptarë, siç janë: Meyr, Çabej etj, gjuha shqipe, më shumë se çdo gjuhë tjetër ballkanike, ruan emërtesat e lashta, të huazuara nga latinishtja, për ditët e javës e që kryesisht lidhen me emra planetësh që janë emërtuar sipas perëndive, siç janë: Marsi, Mërkuri, Saturni, Dielli dhe Hëna. Gjatë hulumtimeve që janë bërë për emrat e ditëve të javës në gjuhën shqipe, është ardhur deri te presupozimi se në shqipen e lashtë java ka filluar me të martën (Çabej), pra, Marsin - perëndinë e luftës, që lë të nënkuptohet se Marsi mund të ketë qenë edhe perëndi e shqiptarëve. Kjo ka shumë të ngjarë të jetë kështu, pasi që edhe në kalendarin e vjetër romak viti fillonte me 1 mars.

Sipas shumë studiuesve eminentë të huaj e shqiptarë, siç janë: Meyr, Çabej etj, gjuha shqipe, më shumë se çdo gjuhë tjetër ballkanike, ruan emërtesat e lashta, të huazuara nga latinishtja, për ditët e javës e që kryesisht lidhen me emra planetësh që janë emërtuar sipas perëndive, siç janë: Marsi, Mërkuri, Saturni, Dielli dhe Hëna. Gjatë hulumtimeve që janë bërë për emrat e ditëve të javës në gjuhën shqipe, është ardhur deri te presupozimi se në shqipen e lashtë java ka filluar me të martën (Çabej), pra, Marsin - perëndinë e luftës, që lë të nënkuptohet se Marsi mund të ketë qenë edhe perëndi e shqiptarëve. Kjo ka shumë të ngjarë të jetë kështu, pasi që edhe në kalendarin e vjetër romak viti fillonte me 1 mars.

Deri tek ky përfundim është arritur gjatë përpjekjeve për shpjegimin e ditëve të javës: e enjte dhe e premte. Meqë ditët e tjera kanë huazime të lashta latine si: e diel - dies Solis „dita e Diellit”; e hëne - dies Lunaea „dita e Hënës”; e martë - dies Martius; e mërkurë - dies Mercuri; e shtunë - dies Saturni, ditët e enjte dhe e premte, me sufiks - te, dalin më të errëta për shpjegim.

MARSI - PERËNDIA E LUFTËSTEKROMAKËT E VJETËR

Emrin e enjte, Mjeda e krahason me greqishten e vjetër, ené - „e treta ditë, dita e pasnesërme” si një numëror rreshtor. Këtë version e pëlqen edhe Çabej si më të arsyeshëm, më të afërt dhe më të mbështetur nga të gjitha krahasimet tjera, edhe për faktin se ditët e javës edhe në shumë gjuhë tjera indoevropiane shënohen shpesh me numërorë rreshtorë, si: s.kr. vtornik „e martë” (e dyta), četvrtak „e enjte” (e katërta), petak „e premte” (e pesta); gr. e re: dheftera „e hënë” (e dyta), triti „e martë” (e treta), detarti „e

mërkurë” (e katërta) etj. Kur të krahasohen edhe emrat e muajve, gjithashtu me prejardhje latine, september „shtator”, octomber „tetor”, november „nëntor”, december „dhjetor” që janë emërtuar sipas numërorëve rreshtorë: i shtati, i teti, i nënti, i dhjeti, si rrjedhojë e muajt të parë të vitit, që në periodën romake fillonte me 1 mars, atëherë supozimi i mësipërm se java te shqiptarët e lashtë do të ketë filluar të martën, dhe se krye-Hyji shqiptar do të



ketë qenë Marsi, është i plotkuptimtë.

Emërtimin Mars e hasim në dy kup-time: te grekët, që e identifikuan me perëndinë e tyre të luftës - Ares, dhe tek romakët, të cilët në fillim e njihnin si perëndi të vegjetimit të tokës e të maleve, e më vonë si perëndi lufte. Prandaj, edhe fillimi i vitit tek romakët fillonte me muajin mars, me 1 mars, në muajin e ekunikosit (barasnatës) të pranverës, në muajin e ringjalljes së natyrës, që marrë realisht, është shumë më e natyrshme sesa fillimi i viti, sipas kalendarit të krishterë, me 1 janar.

Ndërsa emërtimi i Marsit me emra zotërash lufte, ka të bëjë me ngjyrën e kuqe që posedon ky planet. Për njerëzit e lashtësisë kjo dukje e kuqe e tij lidhej me forca të panjohura që zakonisht posedonin fuqi të mëdha mbinatyrore. Pasi ngjyrë të kuqe ka edhe zjarri dhe gjaku, ky planet merrej si simbol i luftërave, shkatërrimeve, djegieve etj. Dhe, po të shfletohet kronologjia botërore e krizave

të luftës, dallohet qartë se shumica e sulmeve është ndërmarrë mu në muajin mars! Po i përmendim vetëm dy rastet më të fundit: sulmi i përbashkët i SHBA-së dhe britanezëve ndaj Irakut që filloi më 20 mars të vitit 2003, si dhe sulmi terrorist që ndodhi me 11 Mars 2004 në kryeqytetin e Spanjës, Madrid, ku vdiqën qindra dhe u plagosën mijëra vetë. Por, ne do ta pasqyrojmë këtu vetëm një historik të shkurtër të historisë sonë që ka lidhshmëri me fillimin e luftërave dhe kryengritjeve të armatosura në muajin mars:

- Më 27 mars 1881, qeveria e Stambollit dhe ajo e Athinës nënshkruan marrëveshjen e re kufitare, që i mundësoi Portës së Lartë veprime ushtarake ndaj autonomisë shqiptare. Po në atë muaj, ajo organizoi një ekspeditë ushtarake të përbërë nga 40 batalione në krye me Dervish Pashën që sulmuan forcat tona në krye me Sulejman Vokshin.

- Më 18 mars 1908 forcat turke, pas vrasjes së komandantit turk të xhandarmerisë në Gjiro-kastër, nisën ekspeditën ushtarake kundër luftëtarit të lirisë, Çerçiz Topulli, që njihet si Lufta e Mashkullores.

- Më 24 mars 1911 filloi kryengritja e madhe e udhëhequr nga Dedë Gjo Luli që shumë shpejt u shtri në gjithë Malësinë e Shkodrës. Pas dy javë luftimesh të suksesshme, ata arritën që më 6 prill, ta ngritin flamurin shqiptar në majën e Bratilës së Hotit.

- Më 22 mars 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër,

vendosi të copëtojë rëndë trojet shqiptare duke shkëputur nga Shqipëria gjithë Kosovën dhe Çamërinë si dhe viset tjera shqiptare, si: Tetovën, Dibërën, Gostivarin etj, që pati si pasojë kryengritje të shumta të armatosura.

- Më 7 mars 1914, arriti në Durrës, si princ i Shqipërisë, gjermani Vilhelm Vid, i zgjedhur nga fuqitë e mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

- Më 7 mars 1919, delegacioni i qeverisë shqiptare që shkoi në Konferencën e Paqes, që u mbajt në Paris (1919-1920), ia paraqiti kësaj konference propozimin që në krahinat shqiptare që kishin mbetur jashtë kufijve të vitit 1913, të vendoseshin forcat e SHBA-së për t'i administruar ato (90 vite më vonë forcat e NATO-s, të udhëhequra nga SHBA-ja, u vendosën në Kosovë).

- Në mars 1920, u krijuan disa komitete të „Mbrotjes kombëtare” për çlirimin e krahinave të pushtuara nga Italia dhe Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene. Disa

muaj më vonë filloi sulmi i kryengritësve shqiptarë në krahinën e Vlorës që së shpejti u shndërrua në një kryengritje të të gjithë popullit shqiptar.

- Më 25 mars 1939, qeveria italiane ia paraqiti Ahmet Zogut një traktat për nënshkrimin e Shqipërisë. Dy javë më vonë trupat fashiste italiane sulmuan Shqipërinë.

- Më 11 mars 1981, në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, filluan demonstratat e studentëve për lirinë e popullit shqiptarë të Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në Jugosllavi e që u përhapën në shumë qendra të tjera të Kosovës, si më 26 mars në Prizren etj.

- Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës, me direktiva nga Serbia, miratoi amendamentet kushtetuese nëpërmjet të cilave u hoq plotësisht subjektiviteti politik dhe ekonomik i Kosovës. Populata shqiptare e revoltuar nga kjo tradhti (meqë prej 136 delegatëve shqiptarë në këtë kuvend, vetëm dhjetë prej tyre refuzuan këtë miratim) vërshoi rrugët me demonstrata masive që u shuan me gjak nga okupatori serbomadhi.

- Më 26 mars 1990, populli i Kavajës, për herë të parë, pas një periudhe të gjatë nën regjimin komunist, mori guximin dhe shpërtheu në një demonstratë të fuqishme antikomuniste, që u shtyp me dhunë, por që ndikoi dukshëm në ndryshimet pluraliste në Shqipëri, të cilat pasuan një vit më vonë.

Adem Jashari

- Më 5 mars 1998, forca të mëdha ushtarake-policore serbe rrethuan Prekazin legjendar. Epiqendër ishin kullat e Jasharajve ku u zhvilluan luftime të rrepta për tri ditë e net rresht mes forcave të UÇK-së, të udhëhequra nga Komandanti Legjendar, Adem Jashari, dhe makinerisë së rëndë serbe. Në këto luftim ra heroikisht komandanti, Adem Jashari, dhe 47 anëtarë të tjerë të lagjes Jasharaj.

- Më 24 mars 1999, NATO filloi sulmet ajrore mbi ushtrinë, policinë dhe forcat paramilitare serbe, si kundërpërgjigje ndaj dhunës dhe masakrave që zhvillonin ato mbi popullatën shqiptare dhe, pas tre muaj bombardimesh, e detyroi Beogradin të kapitullojë dhe e detyroi atë që t'i tërheqë të gjitha forcat e armatosura nga Kosova.

- Më 17 mars 2004 shpërthyen trazirat në Kosovë ku humbën jetën me dhjetëra dhe u plagosën me mijëra protestues. Shkaktar i këtyre trazirave ishte mbyjtja e tre fëmijëve shqiptarë nga fshati Çabër në lumin Ibër, si pasojë e kërcënimit dhe ndjekjes nga ekstremistët serbë, si dhe bllokimi i aksit rrugor Prishtinë - Shkup në Çagllavicë, po ashtu nga ekstremistët serbë.

- Më 8 mars 2005 Kryeministri i Kosovës dhe luftëtari i lirisë Ramush Haradinaj, bashkë me dy bashkëluftëtarë të tij, akuzohet nga Tribunali i Hagës për krime lufte, dhe me 9 mars 2005, ai shkon vullnetarisht në Hagë.

A është kjo lidhshmëri reale, që besohet edhe nga popujt e lashtë, të cilët mu për këtë edhe e kanë emërtuar Marsin me emra zotërash lufte, apo është kjo vetëm rastësi? Pyetje që hapë debate e polemika të shumta! Përgjigjja, megjithatë, mungon!

Apolineri

një shkrim për princërit e rremë shqiptarë



Moikom Zeqo

Në revistën "Albania" të Faik Konicës kisha lexuar dhe skeduar para shumë vitesh një shënim për një artikull të poetit të madh francez Gijom Apolinerit me një subjekt bizar, që lidhej me Shqipërinë.

Teksti i plotë i artikullit të Apolinerit, titulluar në frengjisht "Deu faux principes d'Albanie" ("Dy princëra të rremë të Shqipërisë") botuar së pari në revistën "Leuropeen", e përmendur nga Konica në "Albania", viti IV, III, 1900, më ra në duar i kseroksuar i tëri dhe duke e lexuar mund të përvijoj për lexuesin shënimin prezantues dhe komentues si më poshtë:

Apolineri ka pasur interresa kulturore të jashtëzakonshme.

Ai ka pasur lidhje të ngushta miqësore me Faik Konicën, shqiptarin erudit, që për Apolinerin, ishte më shumë se sa një enciklopedi e gjallë.

Artikulli i Apolinerit për princërit e rremë të Shqipërisë mendoj se evokon raportet e njohjes me Konicën në optikën e interesimeve për atdheun e lashtë dhe misterioz të mikut të tij shqiptar.

Është një dukuri e habitshme në jetën politike europiane, që shumë figura me kombësi tjetër, të interesoheshin për Shqipërinë dhe befas të vetëshpallëshin si mbretër, ose princër me trung gjenealogjik nga familja e Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

Vepra e Barletit, e përkthyer që heret në gjuhët e mëdha të kontinentit të vjetër, ngacmoi imagjinatën e gjithfarë aventurierësh profesionistë, kaq tipikë për Evropën.

Apolineri e njihte mirë këtë dukuri, kur shqiptarofilia qe një dimension origjinal politik.

Apolineri përmend së pari Arlando Kastriotin, një spanjoll fantast, i cili mbiquhej me mbiemrin e Skënderbeut, për t'u paraqitur në opinion si trashëgimtari i tij legjitim dhe i vetmi.

Apolineri tregon me ironi të admirueshme, se spanjollit i dyshimtë, nuk mund të kishte pretendim gjenealogjik, për arsyen e thjeshtë se i fundmi i derës kastriotase u vra në luftën e Pavies në 1525, kurse trashëgimia në vijë femërore gjithashtu kish humbur.

Për Arlando Kastriotin, personazh ndërkaq i njohur edhe nga shq-

Nga iptarët e kohës, ka qaq shumë të dhëna dhe informacion sa nuk është vendi këtu të zgjatemi.

Interesant është edhe fakti që Apolineri njeh me kompetencë historinë e Skënderbeiadës së shek. XV si dhe literaturën profesionale shkencore gjenealogjike.

Më pas Apolineri në artikull bën fjalë për një të ashtuquajtur princ i Shqipërisë me emrin Stefan Anton Zanoçi. Apolineri kishte lexuar në fillim një libër të këtij njeriu, kushtuar historisë së Skënderbeut. Libri quhej "Le grand Castriotte d'Albanie, Francfort 1779 me autor Stiepan - Anton Zannovich - Wiskowich. Apolineri përmend botimin, ose më saktë ribotimin e këtij libri, në Amsterdam, në 1786. Ky personalitet ambikuid, nga më aventuriozët, sipas Apolinerit, ishte me origjinë sllavo-shqiptare (dalmatinas) dhe kishte lindur me 1751. Erudit, tepër i shkathët, u bë i njohur në tërë oborret mbretërore të Europës, shkruante libra me talent të fuqishëm, kishte një vizion të padyshimtë iluminist, kishte takuar

i malazezëve, patrik i kishës greke, pan i madh i Polonisë, princ i së shenjtës perandori romake, dukë i Hercegovinës, fisnik i Venedikut, i madh i Spanjës i klasës së parë, Kryelutës i Maltës, Kryetar i Urdhërit të shën Kastriotit, ose i njëmbëdhjeti zbritës (pasardhës) i Skënderbeut. Veprimet e Zanoçit qenë nga më të pabesueshmet. Kështu ai hyri në tratativa me Hollandën për t'i vënë në shërbim ushtarak për ndihmë 20 mijë shqiptarë(?!). Megjithë admirimin e veçantë të Zanoçit në librat e tij për Shqipërinë dhe kryetrimin shqiptar ai i quan shqiptarët "diamantë të pagdhëndur". Miqësia e tij me baronin Kloats, i krijoi mundësi të lidhjeve nga më të fshehtat, të nëndheshme, me diplomacinë dinake të kohës. U fut në burg në qytetin e Hamburgut me akuzë të rëndë (kishte me vete dy djelmosha homoseksuale). Më vonë u burgos edhe në Amsterdam dhe pikërisht në burg i dha fund jetes se tij duke prerë damaret me thonj, në vitin 1786, duke mbyllur kështu kapitullin e fundit të një nga jetëve



dhe njohur personalisht Volterin, Rusonë, Frederikun e Madh etj. Libri i tij për Skënderbeun pati një jehonë të jashtëzakonshme në opinionin kulturor dhe politik evropian për frymën volteriane antikierikaliste, për karakterin eseistik e filozofik, sipas iluminizmit, që duket, sidomos, në një paraqitje të një testamenti të Skënderbeut, që ishte në fakt një traktat filozofiko-politik për "absolutizmin e ndritur" të një mbreti filozof sipas modelit të vjetër të Platonit. Libër tjetër i Zanoçit është edhe "Kurani i princërve. Duke u vetëshpallur si trashëgimtar e imitues i fronit mbretëror të Shqipërisë Zanoçi pretendonte të luante një rol kryesor në teatrin e politikës evropiane.

Kështu ky personazh i pazakontë, i kishte vënë vetes tituj të tillë të bujshëm si Kastriot, princ i Shqipërisë, Kapedan i përgjithshëm

rjerëzore më të shqetësuar dhe aventuroze në shekuj.

Në fund të artikullit Apolineri përmend kalimthi edhe një të vetëquajtur tjetër si kastriotas në vitet 1879-1880, që i kishte akorduar titullin "markez" vetë shkrimtarit Aleksander Dymas. Apolineri operon në artikull me indikacione historike letrare etj. Për një mendje kurioze si Apolineri nuk mund të nënçmohej habia që ngjallnin veprimet e princërve të rremë, aq më tepër që kjo dukuri e "Dimitërve të rremë, lidhej edhe me kombet e tjerë dhe shumë të vjetër në histori.

P.sh. njihet nga kronikat se kur normanët pushtuan Durrësin në shek. XII paraqitën edhe një perandor të rremë të Bizantit. Ose le të kujtojmë edhe historinë e Xhem Sulltanit të vërtetë, vëllait të presupozuar të Sulltanit të vërtetë të perandorisë osmane që mbahej në

oborret evropiane dhe krijoi lidhje edhe me krerë të kryengritjeve shqiptare antiosmane.

Së fundi, do të ishte me interes të mblidheshin disa nga shkrimet e Apolinerit për Shqipërinë, korrespondenca e tij brilante intelektuale e klasit të parë me Konicën në një libër të veçantë që do të ishte një befasia e kënaqësi e vërtetë mendore për ne shqiptarët, por edhe për të tjerët.

Apolineri per Konicën

I veçanti

Nga të gjithë njerëzit që kam njohur dhe i kujtoj me kënaqësinë më të madhe, Faik Beg Konica është njëri prej të veçantëve. Ai lindi në Shqipëri, rreth 40 vjet të shkuara (1875) nga një familje që i kishte qëndruar besnike besimit katolik".

Revista "Albania"

Faiku vazhdoi studimet, por pasi ishte i mbushur plot dashuri për vendlindjen Shqipëri u kthye në Turqi, ku u angazhua në veprimtari anti qeveritare, dhe u dënua dy herë me vdekje në mungesë. Ai u kthye perseri në Francë, për gjuhën dhe letërsinë e së cilës kishte njohuri të shkëlqyera. Në Francë, Faiku krijoi lidhje të ngushta me çdo njeri që kishte të bënte me Shqipërinë. Megjithatë, ai pa se shkalla e lirisë së individit që lejohej në Francë ishte e pamjaftueshme, dhe shkoi në Bruksel, ku në Rue d'Albanie themeloi revistën Albania, e cila fillimisht trajtoi çështje politike dhe pastaj edhe më gjërë duke përfshirë çështjet e letërsisë, historisë dhe filologjisë. Me këtë Faiku e rigjallëroi jashtëzakonisht lëvizjen shqiptare. Duke pastruar gjuhën shqipe nga fjalët e huaja e parazitare që kishin vërshuar në të, Konica arriti brenda pak vitesh ta shndërrojë atë nga një dialekt te ngushtë në një gjuhë të bukur, të pasur e mjaft shprehëse".

Në stacionin poli-

cor

Megjithatë, liria ashtu siç kuptohej ajo në Bruksel, nuk e kënaqi Faikun më shumë se sa liria që kishte provuar në Paris. Një ditë ai e pati punën keq kur një polic e ndaloi në rrugë. "Nga jeni?", e pyeti polici. "Albania", u përgjigj Faiku. "Adresa?", e pyeti perseri polici. "Rruga Albania", ia ktheu Faiku. "Profesioni?" "Redaktor i Albanias." thote Faiku. "Po talleni me mua?", reagoi polici i zemëruar. Dhe patrioti shqiptar e kaloi atë natë në stacionin e policisë derisa çështja u sqarua".

Takimi i parë

Unë nuk e kisha takuar ndonjëherë. Ai më kishte ftuar për të kaluar disa ditë me të, dhe pati premtuar të më priste në stacionin e trenit. Ndonjë shenjë ishte e nevojshme nga e cila unë mund të dalloja se ishte ai. U morrëm vesh

që Faiku të vendoste në jaken e xhaketes një lule. Treni me të cilin po udhëtoja arriti shumë vonë, dhe në stacionin Viktoria unë pashë se të gjithë zotërinjtë në platformë mbanin lule në jakat e xhaketave të tyre. Si do ta dalloja une mikun tim shqiptar?, pyeta veten. Atehere mora një taksì dhe mbërrita në shtëpinë e Faikut pikërisht në kohën kur ai po dilte për të blerë lulen."

Drekat, shëtitjet dhe bisedat

Faik Beg Konica kishte një pasion për klarinetën dhe oboen. Në dhomën e ndenjes ai kishte një koleksion të vjetër të këtyre instrumenteve. Para dite, ndërsa prisnim të vinte koha e drekës, e cila gjithmonë shtrohej me vonesë, Faiku luante melodi të vjetra, ulur pranë tryezës me sy gjysmë të mbyllur e me pamje mjaft serioze. Dreka ishte "a l'albanise", me fjalë të tjera, e bollshme e pafund. Çdo dy ditë për ëmbëlsirë kishim qumështor, që unë nuk e pëlqeja aspak.

Faiku e donte shumë. Ditët e tjera kishim një lloj keku që unë e pëlqeja shumë.

Faiku nuk donte as ta shikonte me sy. Drekat zgjasnin aq shumë sa unë nuk pata mundësi të vizitoja goftë edhe një muzeum në Londër - ne arrinim atje pikërisht në kohën kur dyert mbylleshin. Megjithatë, ne bëmë shetitje të gjata dhe une pata rastin të njihem me intelektin e lartë e të përkryer të Faik Konicës."

Miqësia ndaj meje

Mua më bënte gjithnjë e më shumë përshtypje miqësia që Faiku tregonte për mua. Unë isha në gjendje t'a kuptoja se ajo ishte një ndjenjë e pastër që rridhte natyrshëm prej tij. Thujse si të gjithë shqiptarët me prejardhje nga familje te njohura, Faiku kishte prirjen për t'u pushtuar nga mania e persekutimit, shqetësimi i madh deri në dëshpërim. Dhe shqetësimet e tij merrnin forma nga më të çuditëshmet. Pasi blente diçka në dyqan, Faiku gjithmonë largohej me frikën se shitësi do të vraponte pas tij për t'a akuzuar se e kishte vjedhur mallin.

"Si do t'ja provoja se nuk e kisha vjedhur?" thoshte gjithmonë Faiku.

Shtypshkronja me germa platini

I ngopur me Brukselin, Faik Beg Konica u nis për në Londër. Ai e braktisi shtypshkronjën e tij të mrekullueshme, e përbërë vetëm nga germa platini me të cilat ai vetë hartoi dhe shtypi një numër librash të formatit të vogël, libra jashtëzakonisht të rrallë. Kjo veprimtari pati jetë të shkurtër pasi punëtori i tij i vetëm në shtypshkronjë u tregua i pakujdesshëm dhe pllakat me germa të rralla u prishën".

Konica dhe feja

Kjo Shqipe" ("Chkipe") u rit në Francë dhe rreth moshës 20 vjeç ishte mjaft fetar sa që një herë kishte shfaqur idenë për të hyrë në Grande-Chartreuse, manastir katolik në veri të Grenobles. Megjithatë ai nuk hodhi asnjë hap në këtë drejtim. Gradualisht përkushtimi ndaj fesë u shndërruar jo në indiferentizëm, por në një lloj anti-klerizëm si ai i Merimesës".

(*)Disa nga kujtimet e Apolinerit për Konicën shkruar rreth vitit 1912, përfshirë në librin "APOLINAIRE Poet Among the Painters", nga Francis Steegmuller